DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXV / Nr. 10 / TETOR 2026



MËSHIRA
QË RINGJALL SHPRESËN

ISSN 2226-7115

“DRITA ISLAME”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

www.dritaislame.al

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTORE
Fatma Karaj


DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax +355 67 43 62 300
E-mail: fatma.karaj@kmsh.al

Viti XXXV i botimit
Nr. 10 (519)
Tetor, 2026

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



Përmbajtja

editorial

04 **Mëshira që ringjall shpresën**
Dorian Demetja

në fokus

06 **Gruaja dhe shëndeti: Nga ndërgjegjësimi te përgjegjësia për veten /** Arjola Senja

lajme / aktivitete

08
01-Përmbyllet edicioni i katërt i trajnimit për imamë dhe hatibë në Shqipëri
02-Kryetari i KMSH-së prezanton modelin shqiptar në përballjen me ekstremizmin
03-Instituti i Studimeve Islame "Hafiz Sabri Koçi" çel vitin e ri akademik 2026–2027
04-Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, zhvillon vizitë pune në Myftininë e Krujës
05-KMSH zhvillon një aktivitet sensibilizues në spitalin Onkologjik të Tiranës

refleksione

14 **Kur bukuria ia lë vendin progresit**
Abdullah Bulku

çështje fetare

20 **Cila është urtësia e zbritjes së Kuranit në 23-vite?**
Këshilli për Çështjet Fetare - insi.al

familja

22 **Interneti në shtëpi: Mundësi dhe rreziqe për fëmijët**
Zamira Merja

horizonti i besimit

24 **Në lidhje me ëndrrat**
Taulant Bica

26 **Të menduarit globalisht dhe pasojat e tij negative /** Bilbil Talla

28 **Roli i figurës së gruas në epokën profetike**
Fatma Karaj

30 **Historia e dy pronarëve të kopshteve**
Sulejman Spahiu

bota shpirtërore

32 **Durimi, një virtyt që sjell shpërblim**
Elvis Hymeraj

hapësira rinore

34 **Dashuria e Profetit ﷺ për nënën dhe babanë**
Marsida Dani

36 **Fëmijët që flisnin që në djep**
Marsida Dani

këndi i poezisë

38 **Kur na hyri Kur'ani në shtëpi**
Dragush Selahudin Çabej











MËSHIRA
QË RINGJALL SHPRESËN



Në jetën e njeriut ka momente kur rrugët duket sikur mbyllen. Njeriu humbet diçka të dashur, sëmuret, përjeton vështirësi ekonomike, përballet me probleme në familje, zhgënjehet nga njerëzit ose shikon gjendjen e shoqërisë dhe pyet: "A do të bëhet më mirë?"

Besimtari mund të trishtohet. Mund të qajë. Mund të lodhet. Mund të përjetojë frikë. Por ka diçka që nuk duhet ta humbasë kurrë: Shpresën tek Allahu. Sepse humbja e shpresës nuk është thjesht një gjendje emocionale. Ajo prek mënyrën se si e shohim Allahun, mëshirën e Tij dhe të ardhmen tonë.

Allahu i Madhëruar na drejtohet me një prej ajeteve më shpresëdhënëse të Kuranit: **"Thuaj: O robërit e Mi që e keni ngarkuar veten me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Vërtet, Allahu i fal të gjitha gjynahet. Ai është Falësi i Madh, Mëshirëploti." (Kuran, Surja Zumer, 39: 53)**

Vini re diçka shumë të bukur. Allahu nuk u drejtohet këtu njerëzve pa mëkate. U drejtohet pikërisht atyre që kanë gabuar shumë. Megjithatë u thotë: "O robërit e Mi..." Sikur të na mësojë: Ke gabuar, por dera Ime nuk është mbyllur. Je larguar, por mund të kthehesh. Ke rënë, por mund të ngrihesh përsëri.

Zoti thotë: **"Mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut"**, sepse njeriu që humbet shpresën fillon të thotë: "Unë nuk ndryshoj dot." "Fëmija im nuk bëhet më mirë." "Shoqëria nuk përmirësohet." "Unë kam bërë shumë gjynahe." "Lutjet e mia nuk pranohen." "Nuk ia vlen të përpiqem." Dhe dalëngadalë pushon së vepruari. Prandaj shejtani nuk ka nevojë gjithmonë ta bindë njeriun të bëjë një mëkat të madh. Ndonjëherë i mjafton ta bindë se nuk ka më shpresë.

Një parim shumë i rëndësishëm që duhet ta kemi kujdes: Nëse një gjë nuk mund ta arrijmë të gjithën, nuk duhet ta braktisim të gjithën. Nuk arrin të jesh një besimtar i mirë? Bëj atë që mundesh. Nuk arrin të falësh shumë namaze nafile? Ruaj pesë namazet. Nuk ke mundësi të japësh shumë sadaka? Jep pak. Nuk mundesh ta ndryshosh shoqërinë? Përmirëso familjen tënde. Nuk mund të edukosh 1000 njerëz? Ndihmo një njeri. Pra, shpresa në pikëpamjen e islamit nuk është të presësh pa bërë asgjë. Shpresa është të vazhdosh të punosh duke besuar se Allahu mund t'i japë bereqet përpjekjes tënde.

Shpresa e besimtarit nuk buron nga fakti se gjithçka po shkon mirë. Përkundrazi. Mund të mos shkojë mirë asgjë për momentin. Por besimtari mendon: "Unë nuk e di çfarë do të ndodhë nesër, por e di në dorën e Kujt është e nesërmja." Kjo është shpresa.

Njeriu sheh vetëm momentin. Allahu sheh fillimin dhe fundin. Ne shohim një derë të mbyllur. Allahu di 100 dyer të tjera. Ne shohim një fatkeqësi. Allahu mund të ketë vendosur brenda saj një mirësi që ende nuk e kuptojmë.

Profeti (a.s.) shkoi në Taif duke shpresuar se njerëzit do ta dëgjonin mesazhin e tij. Por çfarë ndodhi? E refuzuan. E fyen. Nxitën njerëzit kundër tij. U largua nga Taifi i plagosur. Nëse do ta shikonim ngjarjen vetëm me syrin njerëzor, mund të thoshim: "Misioni dështoi." Por Profeti (a.s.) nuk e humbi shpresën te Allahu. Kur iu dha mundësia që populli i Taifit të dënohej, ai nuk kërkoi shkatërrimin e tyre. Përkundrazi, shpresoi se prej pasardhësve të tyre do të dilnin njerëz që do ta adhuronin Allahun. Dhe ashtu ndodhi.

Edhe profeti Jusuf (a.s.), akoma fëmijë hidhet në pus nga vëllezërit e vet. Merret si rob. Shitet. Akuzohet padrejtësisht. Futet në burg. Nëse historinë do ta ndalonim këtu, do të dukej si një tragjedi. Por historia nuk mbaroi në pus. Nuk mbaroi as në skllavëri. Nuk mbaroi as në burg. Mbaroi me nderim, autoritet, bashkim familjar dhe falje.

Kjo na jep një mësim të madh: Mos e gjyko jetën tënde nga kapitulli që po jeton sot. Sepse ti nuk e di se çfarë ka shkruar Allahu në kapitullin tjetër. Prandaj një vështirësi që sot na bën të qajmë, nesër mund të jetë pikërisht shkaku për të cilin do ta falënderojmë Allahun.

Profeti Jakub (a.s.) humbi Jusufin. Kaluan vite. Dhimbja ishte aq e madhe sa Kurani përshkruan edhe ndikimin e saj në shikimin e tij. Por Jakubi nuk tha: "Gjithçka mbaroi." Ai vazhdoi të shpresonte. Kjo na mëson se vonesa nuk do të thotë refuzim. Ndonjëherë ne bëjmë dua një javë dhe themi: "Pse nuk u bë?" Profeti Jakub (a.s.) priti vite.

Profeti Junus (a.s.) gjendej në 3 errësira: në errësirën e natës, në errësirën e detit dhe në barkun e peshkut. A mund të imagjinohet një situatë më e pashpresë? Nuk kishte anije. Nuk kishte njeri. Nuk kishte mjet shpëtimi. Por kishte një derë që nuk mbyllet: dera e Allahut. Ai iu drejtua Allahut: **"La ilahe ila Ente, subhaneke, ini kuntu mine-dhalimin." "Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje. Ti je i Lartësuar! Vërtet, unë kam qenë prej të padrejtëve."** Dhe Allahu e shpëtoi. Këtu kemi një rregull të madh shpirtëror: Kur mbarojnë mundësitë tona, nuk mbaron fuqia e Allahut.

Këtu duhet të bëjmë një dallim. Islami nuk na mëson optimizëm bosh. Njeriu nuk mund të thotë: "Allahu është Mëshirues", dhe të vazhdojë qëllimisht në mëkat. "Allahu do të më ndihmojë", dhe të mos punojë. "Allahu do ta edukojë fëmijën tim", dhe vetë të mos merret me të. "Allahu do ta përmirësojë shoqërinë", dhe vetë të mos bëjë asgjë. Shpresa jonë nuk mbështetet vetëm te aftësitë tona. Po të mbështetej vetëm te ne, do të kishim shumë arsye të dështpëroheshim.

Historia islame nuk është histori e njerëzve që gjithmonë i kishin kushtet në favor të tyre. Është historia e njerëzve që nuk e humbën shpresën kur kushtet ishin kundër tyre. Ibrahimi (a.s.) kishte zjarrin përpara. Musai (a.s.) kishte detin përpara dhe Faraonin pas. Jusufi (a.s.) kishte pusin dhe burgun. Junusi (a.s.) kishte errësirën e detit. Muhamedi (a.s.) kishte Taifin, shpellën, Uhudin dhe armiqtë përreth. Por, mbi të gjitha sprovat dhe vështirësitë, ishte Allahu.

Të mos themi: "Gjithçka mbaroi." Por të themi: "Allahu mund të hapë një derë që ende nuk e shoh." Të mos themi: "Unë nuk ndryshoj dot." Por të themi: "Me ndihmën e Allahut, sot mund të bëj një hap." Të mos themi: "Nuk ka më shpresë." Sepse për sa kohë ekziston dera e pendimit, duaja, Kurani dhe mëshira e Allahut, për besimtarin ekziston gjithmonë shpresa.

Lusim Allahun të mos lejojë që dëshpërimi të hyjë në zemrat tona, të na jap shpresë kur sprovohemi, durim kur presim, forcë kur duhet të veprojmë, si dhe familjeve tona tu japë paqe, fëmijëve tanë udhëzim dhe shoqërisë sonë mirësi.

GRUAJA DHE SHËNDETI: NGA NDËRGJEGJËSIMI TE PËRGJEGJËSIA PËR VETEN

Tetori Rozë përbën një mundësi të rëndësishme për të rikthyer vëmendjen te shëndeti i gruas, veçanërisht te ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit, rëndësia e diagnostikimit dhe depistimit të hershëm dhe nevoja për kujdes të vazhdueshëm shëndetësor. Megjithatë, mesazhi i kësaj fushate shkon përtej një sëmundjeje të caktuar. Ai na fton të reflektojmë mbi mënyrën se si gratë kujdesen për veten, mbi pengesat që i shtyjnë ato të neglizhojnë shëndetin e tyre dhe mbi përgjegjësinë individuale e shoqërore për të krijuar një kulturë të qëndrueshme të kujdesit shëndetësor.

Shëndeti i gruas, pjesë thelbësore e mirëqenies

Shëndeti i gruas nuk mund të kuptohet vetëm si mungesë e sëmundjes. Ai përfshin mirëqenien fizike dhe emocionale, mundësinë për të përfituar nga shërbimet shëndetësore dhe kushtet që i lejojnë asaj të jetojë me dinjitet dhe të përmbushë potencialin e saj në familje e në shoqëri.

Në përditshmëri, shumë gra përballen me përgjegjësi të shumta. Kujdesi për fëmijët, familjen, punën dhe nevojat e të tjerëve shpesh kërkon kohë dhe energji, duke bërë që nevojat personale të kalojnë në plan të dytë. Një vizitë mjekësore mund të shtyhet, një shqetësim mund të shpërfillet dhe një kontroll i nevojshëm mund të mbetet për një kohë të pacaktuar në listën e detyrave të papërfunduara.

Kjo prirje nuk duhet parë vetëm si çështje e zgjedhjeve individuale, pasi ndikohet edhe nga kushtet ekonomike, përgjegjësitë familjare, mungesa e informacionit dhe vështirësitë në marrjen e shërbimeve shëndetësore. Pikërisht për këtë arsye, kujdesi për shëndetin e gruas kërkon jo vetëm ndërgjegjësim personal, por edhe mbështetje familjare e institucionale.

Të kujdesesh për veten nuk do të thotë të neglizhosh të tjerët. Përkundrazi, do të thotë të njohësh vlerën e shëndetit dhe të kuptosh se mirëqenia personale është një pjesë e rëndësishme e jetës, pavarësisht roleve dhe përgjegjësive që mbart.

Tetori Rozë: nga simbolika te veprimi

Kanceri i gjirit mbetet një problem i rëndësishëm i shëndetit publik në mbarë botën. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në vitin 2022 u diagnostikuan rreth 2,3 milionë gra me kancer të gjirit dhe u regjistruan rreth 670 000 raste vdekjesh nga kjo sëmundje në nivel global. Këto shifra dëshmojnë rëndësinë e informimit, diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit të përshtatshëm.

Tetori Rozë është më shumë sesa një fushatë simbolike. Ai përfaqëson një thirrje për të folur hapur mbi shëndetin e gjirit, për të luftuar keqinformimin dhe për të nxitur gratë që të mos i shpërfillin ndryshimet e pazakonta në trupin e tyre. Njohja e shenjave të mundshme dhe konsultimi me mjekun kur vërehet një ndryshim janë hapa të rëndësishëm. Po kështu, kontrollet depistuese duhet të kryhen sipas rekomandimeve mjekësore, duke marrë parasysh moshën dhe faktorët individualë të rrezikut.

Frika nga një diagnozë e mundshme, ndrojtja për të folur rreth shëndetit intim ose bindja se një shqetësim do të kalojë vetvetiu, mund ta vonojnë kërkimin e ndihmës. Për këtë arsye, ndërgjegjësimi nuk duhet të kufizohet te shpërndarja e informacionit, por duhet të ndihmojë në kapërcimin e pengesave që i mbajnë gratë larg kujdesit mjekësor.

Një fushatë e suksesshme nuk matet vetëm nga vëmendja që merr gjatë muajit tetor, por edhe nga veprimet që nxiten në vazhdimësi: informimi i saktë, konsultimi me profesionistët shëndetësorë dhe mundësia reale për të përfituar nga shërbimet e nevojshme.

Përgjegjësia për shëndetin në perspektivën islame

Në perspektivën islame, jeta dhe shëndeti janë mirësi për të cilat njeriu ka përgjegjësi. Kujdesi për trupin, shmangia e dëmit dhe kërkimi i trajtimit kur është i nevojshëm mund të kuptohen si pjesë e një qasjeje të përgjegjshme ndaj këtyre mirësive.

Në Sahihun e Buhariut, Profeti Muhamed (s.a.s) i kujton Ebu Derdasë se edhe trupi ka të drejta që duhen përmbushur. Në kontekstin e hadithit, theksohet rëndësia e ekuilibrit ndërmjet adhurimit dhe të drejtave të tjera. Ky parim mund të shërbejë si pikënisje për një reflektim mbi nevojën që njeriu të mos i shpërfillë kërkesat dhe kufijtë e trupit të vet.

Për gruan, kjo do të thotë se përkushtimi ndaj familjes dhe shërbimi ndaj të tjerëve nuk duhet të shndërrohen në arsye për të lënë pas dore shëndetin. Kujdesi për



veten nuk bie ndesh me përkushtimin fetar dhe as me përgjegjësitë familjare. Përkundrazi, ai mund të shihet si pjesë e përgjegjësisë për të ruajtur një mirësi që i është besuar njeriut.

Gjithashtu, besimi nuk duhet të përdoret si arsye për të shmangur kujdesin mjekësor. Mbështetja te Zoti dhe marrja e masave të nevojshme nuk janë qëndrime kundërshtuese. Informimi, konsultimi me mjekun dhe ndjekja e trajtimit të përshtatshëm janë veprime të përgjegjshme, që mund të bashkëjetojnë natyrshëm me besimin dhe shpresën.

Edhe Kur'ani na fton të reflektojmë mbi shmangien e dëmit. Në suren El-Bekare, ajeti 195, thuhet: "**...mos e hidhni veten në rrezik...**" Ajeti ka një kontekst të caktuar që lidhet me shpenzimin në rrugën e Allahut, ndaj nuk duhet paraqitur e kuptuar si një urdhër i drejtpërdrejtë për kontrollet mjekësore. Megjithatë, në një reflektim më të gjerë etik, ai mund të na kujtojë rëndësinë e veprimit me përgjegjësi dhe të mosneglizhimit të dëmeve që mund të shmangen.

Në këtë kuptim, ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit, vlerësimi mjekësor i ndryshimeve të pazakonta dhe ndjekja e rekomandimeve për depistim janë hapa të arsyeshëm për t'u kujdesur për jetën dhe shëndetin.

Një tjetër parim i rëndësishëm shprehet në hadithin e transmetuar nga Buhariu: "**Allahu nuk ka zbritur asnjë sëmundje, pa zbritur edhe shërimin e saj.**" Ky hadith nxit kërkimin e shërimit dhe ruajtjen e shpresës përballë sëmundjes. Ai nuk nënkupton se çdo sëmundje shërohet patjetër në çdo rast, por na kujton rëndësinë e kërkimit të mjeteve të trajtimit.

Prandaj, besimi dhe mjekësia nuk duhen parë si dy rrugë që përjashtojnë njëra-tjetrën. Lutja dhe mbështetja tek Allahu janë burim force shpirtërore, ndërsa konsultimi me mjekun, kryerja e ekzaminimeve të nevojshme dhe ndjekja e trajtimit janë pjesë e përgjegjësisë praktike. Përballë frikës nga një diagnozë, besimi mund ta ndihmojë gruan të ruajë shpresën, por nuk duhet të bëhet arsye për të shtyrë kërkimin e ndihmës profesionale.

Në një ajet tjetër kur'anor, Allahu thotë: **"Vërtet, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit..."** (Kuran, Surja Isra, 17:70). Ky ajet flet për dinjitetin njerëzor në përgjithësi dhe na ofron një pikënisje për të reflektuar mbi respektin që meriton çdo njeri, pavarësisht gjendjes shëndetësore.

Nga ndërgjegjësimi te kultura e kujdesit

Përgjegjësia për shëndetin e gruas nuk i përket vetëm asaj. Familja ka rol të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi ku ajo ndihet e mbështetur për të kërkuar ndihmë dhe për t'u kujdesur për veten. Institucionet shëndetësore duhet të ofrojnë informacion të besueshëm dhe shërbime të arritshme, ndërsa institucionet arsimore, shoqërore dhe fetare mund të kontribuojnë në edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit.

Në këtë proçes, është e rëndësishme që gratë që përballen me kancerin ose me sëmundje të tjera, të marrin mbështetje pa u stigmatizuar. Ato kanë nevojë jo vetëm për trajtim mjekësor, por edhe për mirëkuptim, respekt dhe përkrahje emocionale. Të flasësh për sëmundjen me ndjeshmëri dhe përgjegjësi, ndihmon në krijimin e një mjedisi ku kërkimi i ndihmës nuk shoqërohet me turp apo fajësim.

Tetori Rozë na kujton se ndërgjegjësimi ka vlerë të vërtetë kur shndërrohet në veprim. Kujdesi për shëndetin nuk duhet të jetë një vendim i marrë vetëm kur shfaqen shqetësime, por pjesë e një qëndrimi të vazhdueshëm ndaj jetës.

Gruaja nuk duhet të presë derisa të mos mundet më të përmbushë përgjegjësitë për të kuptuar se edhe shëndeti i saj meriton vëmendje. Kujdesi për veten nuk është egoizëm, por një përgjegjësi që buron nga respekti për jetën, trupin dhe mirëqenien. Dhe kjo përgjegjësi nuk zgjat vetëm gjatë Tetorit Rozë; ajo na shoqëron gjatë gjithë jetës.

Referenca

1. World Health Organization, Breast cancer — Fact sheet. https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/breast-cancer

2.Moey et al. (2022), Cultural, Religious and Socio-Ethical Misconceptions among Muslim Women towards Breast Cancer Screening: A Systematic Review. https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC9971473/

3. Sahih al-Buhari, https://sunnah.com/bukhari

4. Kur'ani Famëlartë.

01 PËRMBYLLET EDICIONI I KATËRT I TRAJNIMIT PËR IMAMË DHE HATIBË NË SHQIPËRI



Në ambientet e Hotel Plaza në Tiranë u zhvillua ceremonia përmbyllëse e edicionit të katërt të trajnimit treditor për imamë dhe hatibë, organizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe institucioneve përkatëse të Mbretërisë së Arabisë Saudite. Në këtë program morën pjesë rreth 100 imamë dhe hatibë nga zona të ndryshme të vendit, të cilët studiuan veprën "El-Erbeun en-Nevevijje" (Dyzet Hadithet e Neveviut), nën drejtimin e Sheikh Bedër bin Muhamed ed-Deule.

Në ceremoninë përmbyllëse ishte i pranishëm Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, i cili theksoi rëndësinë e formimit të vazhdueshëm të imamëve dhe hatibëve, duke vlerësuar rolin e tyre në edukimin fetar, përhapjen e vlerave morale dhe shërbimin ndaj shoqërisë. Gjithashtu, z. Xhluwi Sa'd el-Hexhle, Përgjegjës i Çështjeve Fetare pranë Ambasadës Saudite në Shqipëri, vuri në pah rëndësinë e dijes fetare dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

KMSH shprehu mirënjohjen për institucionet saudite dhe partnerët që mbështetën realizimin e kësaj nisme. Në përfundim, pjesëmarrësve iu shpërndanë certifikatat e përfundimit të kursit, duke shënuar një tjetër hap në forcimin e përgatitjes shkencore dhe profesionale të imamëve dhe hatibëve në Shqipëri.



















02 KRYETARI I KMSH-SË PREZANTON MODELIN SHQIPTAR NË PËRBALLJEN ME EKSTREMIZMIN



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë "Përpjekjet e Mbretërisë së Arabisë Saudite në përballjen me devijimet ideore", organizuar nga Universiteti Islam i Medinës, nën kujdesin e Princit Salman bin Sultan bin Abdulaziz Al Saud.

Gjatë konferencës, Kryetari Spahiu prezantoi përvojën shqiptare në përballjen me ekstremizmin dhe devijimet ideore, duke theksuar rëndësinë e edukimit, moderimit, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe harmonisë ndërfetare në parandalimin e ekstremizmit.

Në kuadër të aktivitetit, ai zhvilloi takime dhe shkëmbeu përshëndetje me personalitete të larta fetare dhe akademike, përfshirë Princin Salman bin Sultan bin Abdulaziz Al Saud dhe Sheikh Prof. Dr. Abdulrahman bin Abdulaziz Al-Sudais.

Pjesëmarrja e KMSH-së në këtë konferencë përbën një mundësi të rëndësishme për promovimin e modelit shqiptar të bashkëjetesës fetare dhe shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare në forcimin e moderimit dhe parandalimin e ekstremizmit.





03 INSTITUTI I STUDIMEVE ISLAME "HAFIZ SABRI KOÇI" ÇEL VITIN E RI AKADEMIK 2026–2027



Instituti i Studimeve Islame "Hafiz Sabri Koçi", pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, çeli vitin e ri akademik 2026–2027 të programit njëvjeçar të njohurive bazë fetare. Në vitin e gjashtë të këtij programi janë regjistruar rreth 50 pjesëmarrës, burra dhe gra të moshës 15–45 vjeç, nga qytete të ndryshme të vendit. Mësimi do të zhvillohet në format të kombinuar, fizikisht dhe online.

Në ceremoninë e hapjes, drejtori i Institutit, Dr. Elton Karaj, theksoi rëndësinë e kërkimit të dijes, formimit moral dhe përkushtimit ndaj fesë e shoqërisë. Ndërsa Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, i uroi studentët për këtë rrugëtim, duke nënvizuar rëndësinë e përvetësimit të njohurive të sakta islame dhe zbatimit të tyre në jetën e përditshme.

Përshëndetje dhe mesazhe motivuese përcollën gjithashtu drejtori i Arsimit pranë KMSH-së, Dr. Surja Shehi, dhe Dr. Xhemal Saferti, përgjegjës i Departamentit të Shkencave Islame në Kolegjin Universitar Bedër, të cilët vlerësuan rolin e dijes në formimin e imamëve, myezinëve dhe udhërrëfyesve moralë të komunitetit.

Programi përfshin lëndë themelore si Kur'an, Hadith, Tefsir, Fikh, Hitabet, Moral Islam, Akide dhe Histori Islame. Gjatë pesë viteve të mëparshme, Instituti ka certifikuar mbi 180 studentë, duke kontribuar në zgjerimin e njohurive fetare dhe në formimin intelektual e moral të pjesëmarrësve.





04 KRYETARI I KMSH-SË, H. BUJAR SPAHIU, ZHVILLON VIZITË PUNE NË MYFTININË E KRUJËS



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi një vizitë pune në Myftininë e Krujës, ku u prit nga Myftiu, z. Aorel Senja, administratori dhe imamët e qytetit.

Në fjalën e tij të mirëseardhjes, Myftiu Senja falenderoi Kryetarin Spahiu për vizitën dhe e njohur atë shkurtimisht me aktualitetin e Myftinisë, si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë administrativ.

Gjatë takimit, Kryetari Spahiu vlerësoi punën dhe përkushtimin e Myftinisë së Krujës, si dhe angazhimin e imamëve në shërbim të xhamive, besimtarëve dhe komunitetit. Ai nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet palëve, si një element thelbësor për konsolidimin e frymës së solidaritetit, përcjelljen e vlerave islame dhe përmbushjen me përgjegjësi të misionit tonë fetar dhe edukativ.

"Shërbimi ndaj besimtarëve kërkon përkushtim të vazhdueshëm, bashkëpunim të sinqertë dhe një lidhje të fortë me ta. Është e rëndësishme të jemi pranë njerëzve, të dëgjojmë nevojat e tyre dhe të punojmë së bashku për të forcuar vlerat e besimit, familjes, solidaritetit dhe dashurisë për njëri-tjetrin", u shpreh ndër të tjera ai.

Në vijim të vizitës, Kryetari Spahiu mbajti hutben e namazit të xhumasë në Xhaminë e Pazarit në Krujë.

Në ligjëratën e tij, ai u ndal te rinia në Islam, roli i saj në të ardhmen e shoqërisë dhe përgjegjësia që kemi të gjithë për edukimin, udhëzimin dhe mbështetjen e brezit të ri, veçanërisht në përballjen me sfidat e shumta të kohës sonë.







05 KMSH ZHVILLON NJË AKTIVITET SENSIBILIZUES NË SPITALIN ONKOLOGJIK TË TIRANËS



Në kuadër të Tetorit Rozë, muajit të ndërgjegjësimit për rëndësinë e kontrolleve të rregullta të grave dhe vajzave, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Medresenë e Tiranës dhe Medresenë e Elbasanit, zhvilluan një aktivitet në ambientet e Spitalit Onkologjik të Tiranës, në shenjë solidariteti dhe mbështetjeje për gratë dhe vajzat që po përballen me sprova në shëndetin e tyre.

Në këtë aktivitet morën pjesë znj. Fatma Karaj, kryeredaktore e revistës "Drita Islame" në KMSH, z. Helidon Nina, drejtor i Spitalit Onkologjik, znj. Lindita Hoxha, kryeinfermiere e këtij spitali, Mësuese dhe nxënëse të të dy medreseve të lartpërmendura, si dhe dhjetëra gra e vajza që po marrin aktualisht trajtim pranë këtij institucioni shëndetësor.

Në fjalën e saj të rastit, znj. Fatma Karaj shprehu mirënjohjen për drejtuesit dhe personelin shëndetësor për përkushtimin dhe punën e tyre të vazhdueshme, duke theksuar gjithashtu rolin e besimit në përballimin e sprovave të ndryshme në jetë, si burim shprese, force shpirtërore dhe qëndrueshmërie.

Nga ana e tij, drejtori i Spitalit Onkologjik, z. Helidon Nina, falënderoi KMSH-në për organizimin e këtij aktiviteti, duke vlerësuar mesazhin e tij sensibilizues dhe rëndësinë e mbështetjes morale e emocionale për gratë dhe vajzat që përballen me sfida të tilla shëndetësore.

Programi vijoi me disa Ilahi dhe poezi të shkurtra të interpretuara nga nxënëset e dy medreseve, të cilat sollën përmes vargjeve mesazhe të shumta kushtuar figurës së gruas dhe nënës në veçanti, forcës, dinjitetit dhe dashurisë së saj.





I ABDULLAH BULKU I

Kur bukuria ia lë vendin PROGRESIT



Progresi, suksesi, qytetërimi. Këto janë konceptet themelore të çdo debati dhe këndvështrimi që formëson qasjen tonë ndaj arkitekturës. Në debatet intelektuale apo ligjërimet politike, përfytyrimi mbi arkitekturën merr formë përmes këtyre ideve dhe vlerave që kapërcejnë kërkesat praktike, si buxheti apo logjistika. Kjo ndodh për faktin se peizazhi i një qyteti nuk është vetëm një realitet fizik; ai pasqyron mënyrën se si e shohim veten dhe vendin që, si kombe e shoqëri, zëmë në botë.

Megjithatë, kjo krenari qytetare mbart një natyrë të dyfishtë; është, si të thuash, "një thikë me dy presa". Ndërsa nga njëra anë ajo mund të shërbejë si pikë bashkimi dhe konsensusi, nga ana tjetër mund të bëhet po aq lehtë burim debatesh dhe përplasjesh. Gjithnjë e më shumë, banorët i përjetojnë qytetet tona si hapësira të tjetërsimit. Kritikët shpesh ia atribuojnë këtë dukuri arkitekturës moderne, me përmasat e saj masive dhe përdorimin e materialeve sintetike, duke argumentuar se ndërtesa të tilla dobësojnë lidhjen e njerëzve me vendin dhe, në fund, i shtyjnë ata të largohen nga qytetet. Kjo mund të ndodhë për shkak të rritjes së kostos së banimit, ashtu sikurse për arsye abstrakte që lidhen me mungesën e ndjeshmërisë së këtyre hapësirave ndaj nevojave dhe vlerave njerëzore dhe komunitare. Nga ana tjetër, kthimi nostalgjik drejt stileve të së kaluarës, në emër të ruajtjes së traditës, shihet zakonisht si një qasje pretencioze, monotone dhe pa ambicie.

Mes tradicionales dhe modernes

Në pjesën më të madhe të asaj që ndërtohet sot, dikotomia e thjeshtëzuar e tradicionales përballë modernes mbështetet vetëm në kritere të përbashkëta vlerësimi si performanca dhe popullariteti për të përcaktuar vlerën e secilës qasje. [1] Tradicionalistët përqendrohen më shumë në krijimin e një dendësie të moderuar, me hapësira që u japin përparësi këmbësorëve dhe ndërthurin funksione të ndryshme, duke përdorur modele abstrakte, të thjeshtëzuara nga epoka ose stile të së kaluarës. Në anën tjetër, modernistët nuk motivohen më nga ideologjia e pasluftës që synonte të ndërtonte një botë të re egalitare, dhe as eksperimentojnë më në pikëtakimin e shkencës me artin, siç bënin dikur pararendësit e tyre avangardistë. Mjafton të kujtojmë këtu arkitektë si Lina Bo Bardi, arkitektura e së cilës mbartte barrën e drejtësisë shoqërore. I. M. Pei, i cili e vendoste qëllimin në zemër të projektimit, dhe Jorn Utzon, i cili përpiqej të ruante frymëzimin nga natyra dhe qytetërimet e së shkuarës.

Megjithatë, modernistët e sotëm dhe tradicionalistët bashkëkohorë e ndërtojnë veprimtarinë e tyre mbi kriteret e të qenit funksionalë, të gjelbër dhe të qëndrueshëm, duke e reduktuar arkitekturën në një ushtrim të thjeshtë logjik. Ashtu si një kub i Rubikut, ndërtesat e projektuara nga arkitektë si Bjarke Ingels dhe Ole Scheeren janë manifestime të një shqetësimi mbizotërues për të arritur një kuptim matematikor, pa qenë domosdoshmërisht të dashura dhe të pëlqyeshme nga këndvështrimi estetik njerëzor. Për më tepër, përmbushja e këtyre kritereve mund të përdoret pothuajse si një mënyrë për të legjitimuar ata arkitektë të famshëm që kërkojnë njëfarë shfajësimi, si Zaha Hadid, e njohur për krijimet bombastike, tërheqja e të cilave për publikun e gjerë po zvogëlohet, ndërsa gjithnjë e më shumë njerëz po kthehen drejt lidhjes së tyre të brendshme me atë që është e vlefshme dhe e arsyeshme.

Kjo praktikë e varfër në frymëzim e redukton pashmangshmërisht arkitekturën në një gjest të zbrazët, në një grumbullim të thjeshtë blloqesh ndërtimore, qofshin ato të renditura sipas një logjike apo të vendosura kuturu, një veprimtari kjo që mund të kryhet edhe pa arkitektë, vetëm nga zhvilluesit e madje edhe nga inteligjenca artificiale!

Kështu mund të thuhet se, në arkitekturë, qasja tradicionale dhe moderne nuk vazhdojnë të ekzistojnë më në kuptimin klasik të këtyre termave. Përkundrazi, ato kanë pësuar një metamorfozë në versione të reduktuara të vetvetes, duke e lënë aspiratën qytetare të endet në kërkim të një përkufizimi të ri të "progresit". Në anën tjetër, megjithëse pohohet kalimi në një epokë ku dallimet ndërmjet stileve arkitekturore janë kapërcyer (post-style era), ku moderniteti nuk përkufizohet më në kundërvënie me traditën, ai tashmë është shndërruar në një modernitet të "radikalizuar", "të lartë" ose "të lëngshëm". Kështu krahasimi binar ndërmjet tradicionales dhe modernes vazhdon të jetë në vetë thelbin e debateve tona kolektive mbi arkitekturën, edhe pse vetëm përmes hijeve të kuptimeve të tyre fillestare.

Në një kuptim më të thellë, arsyeja e kësaj qëndron në paradigmën e modernitetit, ku dyshimi metodik kartezian do të zëvendësonte sigurinë e së vërtetës hyjnore me relativizmin subjektiv. Kështu, në botën moderne, edhe stilet tradicionale të ndërtimit, të cilat dikur ishin mishërim i botëkuptimit dhe promovimit

1. Lizzie Crook, "Do People Really Prefer Traditional Architecture?," Dezeen, October 30, 2025, https://www.dezeen.com/2025/10/30/traditional-architecture/.



të vlerave më të larta të një shoqërie, sot janë shndërruar në kopje të thjeshta, të përsëritura mekanikisht, të produkteve të së kaluarës.

Moderniteti, i nisur nga dëshira për t'u shkëputur nga e kaluara, e ka përcaktuar rëndësinë e vet përmes prirjes për të përmbysur traditën dhe për të ndërprerë vazhdimësinë historike. Si rrjedhojë, në të gjitha fushat e kulturës e gjejmë veten në një ngërç ndërmjet murit të kiçit [2] dhe spirales së zbrazëtisë.

Një nga pasojat e drejtpërdrejta të paradigmës moderne është se bukuria nuk kuptohet më si një vlerë absolute, sikurse mirësia, por konsiderohet si diçka tërësisht subjektive. Ndoshta do të ishte e mundur që filozofë si Kanti ta shpëtonin bukurinë nga thellësitë asgjësuese të racionalizmit. Por në kushtet e sotme, për arkitektët, si dhe për pjesën tjetër të publikut, të cilët nuk kanë gjithmonë kohën apo mjetet për ta zbërthyer këtë çështje, bukuria dhe estetika, së bashku me shumë vlera njerëzore që mund të ruheshin, janë flijuar në altarin e nocioneve çorientuese, të tilla si progresi dhe suksesi.

Qyteti si fabrikë

Arsyeja përse këto nocione janë çorientuese nuk qëndron te ajo që janë në vetvete, por në mënyrën se si përkufizohen nga moderniteti. Progresi, i konsideruar si vlerë thjesht për faktin se është i ri dhe i ndryshëm, është pjesë e garës së ethshme të shoqërisë moderne, ku tjetërsimi, së bashku me patologjitë e vetmisë dhe të mërzisë, është kthyer në normë. Analogjia famëkeqe e bërë nga Le Corbusier, "Shtëpia është një makinë për të jetuar ", përmbledh pikëpamjen e modernitetit për atë që dikur ishte aspekti më intim i sferës njerëzore. Ajo është një deklaratë se tashmë asgjë që i përket qenies sonë nuk është e pavarur nga dogma e Fabrikës. Në të njëjtën mënyrë, suksesi i qytetit vlerësohet vazhdimisht sipas mënyrës se sa mirë dhe pa pengesa rrotullohen ingranazhet e tij: trenat mbërrijnë në kohë, trafiku rrjedh pa bllokime, infrastruktura funksionon siç pritet e kështu me radhë. Mirëpo, nëse ky është vërtet suksesi, atëherë si mund ta pajtojmë atë me të gjitha krizat që përshkojnë shoqëritë moderne, që nga kostot e larta të jetesës dhe mungesa e strehimit të përballueshëm, deri te vetëvrasja, përdorimi i drogës dhe sëmundjet mendore?

Sikurse theksoj në librin "Building for Hope" (Të ndërtosh për të shpresuar) , "sistemi i Fabrikës" është produkt i industrializimit që mbizotëroi në të gjitha aspektet e jetës pas dy luftërave botërore. Sipas këtij sistemi, qyteti mund të konceptohet përmes prizmit të pesë frikërave themelore të njeriut: vdekjes, nevojës, tradhtisë, vetmisë dhe mërzisë. Shkenca dhe teknologjia, si derivat i saj, janë tashmë pushteti i një botëkuptimi dhe sistemi të ri që synon të mos lërë asgjë jashtë sferës së një sigurie epistemike të krijuar nga njeriu, një siguri që nuk ka më vend për Zotin.

Teoricienët kritikë flasin për ndjenjën e çmagjepjes që ka sjellë moderniteti i mbështetur në prova empirike; sipas kësaj qasjeje mund të kuptohet edhe raporti ynë me ndërtesat. Ironikisht, provat tregojnë vërtet se qeniet njerëzore janë subjekte të dominuara nga

2. Koncepti i " kitch-it" në arkitekturë lidhet përdorimin imitues ose riprodhues të formave dhe elementeve arkitekturore, shpesh të shkëputura nga funksioni, konteksti dhe kuptimi i tyre fillestar, me synim kryesisht krijimin e një efekti të menjëhershëm vizual, emocional ose simbolik.

ndërtesat moderne. Ne përpiqemi me vështirësi të ruajmë nivelet tona të produktivitetit dhe sigurisë në një botë që po del gjithnjë e më shumë jashtë kontrollit. Jemi të rrethuar nga frika në vend të dashurisë, dhe kjo lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si zgjedhim ta përkufizojmë suksesin e vendeve që ndërtojmë dhe në të cilat jetojmë. Edhe kur synimet tona janë të mira, hapësirat vazhdojnë të trajtohen si laboratorë të gjallë në kërkimin tonë shkencor për rezultatet më të mira, ku njerëzit, në mënyrë ideale, mund të socializohen, të jetojnë dhe, në mënyrë të pashmangshme, të shpenzojnë para!

Kostoja e hapësirës

Edhe pse nuk mungojnë kërkimet rigoroze mbi planifikimin urban dhe krijimin e hapësirave identitare, konflikti ndërmjet ndërmjet dy stileve vazhdon të jetë i pranishëm në të gjithë fushën e kërkimit, pa çuar në ndonjë zgjidhje të kënaqshme. Tradicionalistët pretendojnë se, për shkak se mbështeten në një gjuhë arkitekturore që konsiderohet e suksesshme, kanë një lidhje më të madhe me aspiratat kolektive dhe zgjedhjet estetike të njerëzve; prandaj, sipas tyre, këto qasje tërheqin edhe investime për realizimin e ideve të tyre. Modernistët, nga ana tjetër, besojnë se ndikimi i tyre gjithëpërfshirës në rindërtimin e pasluftës i kualifikon ata të marrin përsipër drejtimin e atë që do të vijë më pas. Ata i shpërfillin ankesat e publikut, i cili e gjen veten të tjetërsuar nga një botë e ndërtuar vetëm në funksion të fitimit. Sot, ndërsa përpiqemi të ndërtojmë në një kohë të përshkuar nga krizat e kostos së jetesës dhe të strehimit, diskutimet që kanë të bëjnë me bukurinë dhe rëndësinë morale mund të zhvendosen lehtësisht drejt një liste kriteresh teknike, ndërsa çdo vlerë tjetër hidhet poshtë si subjektive. Kufizimi i një argumenti vetëm te subjektiviteti dhe aspektet teknike është një qasje që kërkon të mbushë zbrazëtinë e lënë nga shpërbërja e një botëkuptimi unifikues. Për shembull, gjuha e Klasicizmit të Ri,[3] e promovuar nga arkitektë si Leon Krier, ofron një formë elegante, ndonëse të zhveshur nga kuptimi, pikërisht sepse nuk mbështetet

3. "Klasicizmi i Ri" është një lëvizje arkitekturore bashkëkohore, e zhvilluar kryesisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, që synon ringjalljen dhe përshtatjen e parimeve estetike dhe urbanistike të arkitekturës klasike e tradicionale. Ai karakterizohet nga përdorimi i simetrisë, harmonisë, proporcioneve dhe elementeve arkitekturore klasike, si dhe nga respektimi i kontekstit historik dhe kulturor. Lëvizja u zhvillua pjesërisht si reagim ndaj modernizmit arkitekturor dhe shkëputjes së tij nga traditat historike të ndërtimit. Ndër përfaqësuesit e saj më të njohur janë Léon Krier, Demetri Porphyrios dhe Robert A. M. Stern.



nga një botëkuptim përforcues që shpreh një ndjenjë kolektive. Në vend të kësaj, këto forma e gjejnë rëndësinë e tyre në sferën e politikës, ku interesat e tregut marrin vendimin përfundimtar. Qendrat historike të qyteteve evropiane janë një shembull i përsosur se si ndërtesat e bukura mund të shndërrohen në forma të zbrazëta të kuptimeve tashmë të humbura, të vëna në shërbim të shijeve të elitës globale dhe kërkesave të turizmit. Përsëri gjendemi përballë një rruge pa krye, ndërmjet varfërimit të shpirtrave dhe varfërimit të xhepave tanë.

Çelësi për zgjidhjen e këtij problemi mund të gjendet përtej botës perëndimore. Në sistemin financiar islam, kreditë me interes janë të ndaluara dhe korporatat nuk kanë monopol mbi jetën e njerëzve. Bizneset e vogla, të cilat përbëjnë bazën e ndërtesave dhe zonave me funksione të përziera, ekzistojnë natyrshëm në mungesë të dominimit masiv të sistemit korporativ të mundësuar nga kreditë. Me gjithë vështirësitë, shoqëritë myslimane, si në vendin tim, në Siri, në përgjithësi vazhdojnë t'i përmbahen rregullit të Islamit, pavarësisht faktit se kreditë me interes ofrohen nga institucionet shtetërore. Zhvilluesit privatë, si edhe pjesëtarët e publikut, e ndërmarrin procesin e ndërtimit pa marrë kredi dhe, në vend të kësaj, vendosin paraprakisht fonde reale dhe të disponueshme nga kapitali i tyre. Kjo sjell dy pasoja. E para është se projektet që ata ndërmarrin janë dukshëm më të vogla se ato që do të ishin të mundshme nëpërmjet kredive me interes, gjë që çon në ndërtesa me lartësi më të ulët dhe me përmasa

më të përshtatshme për njeriun, si dhe krijon ekonomi më të larmishme me një numër më të madh aktorësh. E dyta është se transaksionet e pasurive të paluajtshme zhvillohen mbi bazën e truallit po aq sa edhe të objektit në ndërtim. Për shembull, kontraktorët mund të shesin tetë kate të një ndërtese dhjetëkatëshe që në fillim të procesit të ndërtimit. Fondet që marrin paraprakisht nga këto tetë kate financojnë më pas gradualisht ndërtesën ndërsa ajo ngrihet; fitimi përdoret për ndërtimin e dy kateve të mbetura.

Kjo metodë përbën një dinamikë të rëndësishme në jetën shoqërore. Ndërtimi i banesave nga vetë banorët bëhet i mundur për faktin se qyteti si fabrikë nuk ka hedhur rrënjë në aleancë me bankat. Kjo sjell një shoqëri më organike dhe të larmishme, ku liria nuk sakrifikohet në emër të progresit. Megjithatë, kjo tablo është cenuar nga trashëgimia koloniale, e cila synoi në mënyrë sistematike të shpërbënte të gjitha rrjetet dhe strukturat financiare e shoqërore që dikur mbanin në këmbë një model pune organikisht të lirë dhe të mbështetur në bashkëpunimin e ndërsjellë. Kjo është gjithashtu arsyeja pse stili mbetet një çështje e kontestuar, e humbur së bashku me përkufizimin e identitetit në rajonet postkoloniale. Modernizimi shërbeu si pretekst për paralizimin e institucioneve islame, si vakëfi deri në atë masë, sa sot ai mbetet vetëm një emërtim formal i asaj që dikur përbënte një rrjet financimi bamirës dhe ndërtimi novator.

Rreziqet që moderniteti paraqet për arkitekturën nuk shpërfaqen vetëm në stilin e tij, por ato janë pjesë integrale të sistemit mbi të cilin ndërtohet botëkuptimi i tij. Ky botëkuptim me natyrë individualiste dhe utilitare ka krijuar një normë arkitekturore që lartëson shkëputjen dhe thyerjen e vazhdimësisë në emër të krijimtarisë, duke sjellë tri ndryshime kryesore në mënyrën se si e përkufizojmë arkitekturën e mirë dhe të suksesshme. Së pari, ai ka prodhuar një kulturë zëvendësimi, në të cilën asgjë nuk konsiderohet aq e vlefshme sa të mos mund të zëvendësohet. Qoftë një ndërtesë, një pemë apo, tashmë me inteligjencën artificiale, edhe vetë qenia njerëzore, çdo gjë dhe çdo njeri konsiderohen mjete për arritjen e një qëllimi. Ky qëllim është gjithmonë utilitar, çka do të thotë se nuk shkon përtej vetvetes, nuk ekziston ndonjë qëllim më i lartë dhe as ndonjë e mirë që të shtrihet përtej interesit vetjak. Duke qenë vazhdimisht në shërbim të interesit vetjak, ndërtesat tona, për rrjedhojë, shndërrohen në model edhe për qëllimet e jetës sonë. Së dyti, moderniteti e ka bërë kapërcimin e rekordeve në përmasa një kriter të përparimit, me fjalë të tjera, "sa më e madhe, aq më mirë". Në garën e ethshme për të qenë të pranuar, të mbështetur nga financimi i klientëve të tyre, arkitektët dhe planifikuesit urbanë synojnë madhështinë demonstrative të sasisë, në vend të përparimeve të mirëfillta në cilësi. Përtej dëmit që i shkaktojnë sistemit tonë të vlerave, këto aspirata dëmtojnë planetin, shterojnë burimet e tij dhe na bëjnë të pavetëdijshëm ndaj kostos që secili prej nesh ua imponon të tjerëve. Në këtë kuptim, dëmi i tyre përhapet edhe më gjerë duke formësuar një perceptim dhe model të gabuar sjelljeje në këtë fushë të jetës. Së treti, moderniteti e ka ngritur turizmin si kriter të suksesit të qytetit. Qyteti tashmë është një objekt arti për t'u soditur dhe për t'u shijuar nga të huajt që vetëm kalojnë nëpër të. Këtu, ndërtesat tradicionaliste konkurrojnë në të njëjtën garë me krijimet moderniste. Të dyja e paraqesin qytetin si një hapësirë të asaj që Thomas C. Oden e quan "hedonizëm narcizist", ku vihen në veprim kultura e zëvendësimit dhe arkitektura e rekordeve të përmendura më sipër.

Perspektiva islame/ Krahasimi me Islamin

Megjithëse modernizmi është një projekt perëndimor, shfaqen dy kundërthënie të mëdha



kur ai diskutohet në raport me botën myslimane. E para është se, megjithëse moderniteti është një projekt laik që bie ndesh me të gjitha vlerat dhe parimet e Islamit, bota myslimane e ka përqafuar atë me zell. Kjo ndodh pjesërisht sepse përqafimi i modernitetit shihet si një parakusht për suksesin, diçka që botës myslimane i ka munguar ndjeshëm që prej rënies së Perandorisë Osmane. Kështu është e pamohueshme se bota myslimane nuk ka arritur ta rikonstituojë vetveten në epokën postkoloniale që pasoi atë disfatë, përkundrazi ajo është fragmentarizuar dhe ka rënë nën kontrollin e elitave të korruptuara, të cilat nuk u shkëputën kurrë plotësisht nga projekti kolonial.


Kundërthënia e dytë shfaqet kur marrim në konsideratë historinë dymbëdhjetë shekullore të qytetërimit islam. Nëse moderniteti nënkupton risinë, progresin dhe përparimin, atëherë Islami është përherë modern. Shqyrtimi i stileve arkitekturore islame përgjatë historisë do të nxirrte në pah se Islami nuk u mjaftua kurrë me përsëritjen dhe as krijimet e tij nuk ishin të shkëputura nga vendi, koha dhe historia e tyre. Ai gjithmonë ndërtonte mbi atë që ekzistonte më parë, por nuk kënaqej kurrë vetëm me kopjimin e asaj që ekzistonte më parë. Prandaj mund të thuhet se stili tradicional, në kuptimin që ky nocion ka marrë në Perëndim, nuk është pjesë e historisë së arkitekturës islame.

Për më tepër, në krahasim me modernitetin perëndimor, projekti i Islamit nuk ishte kurrë individualist. Përkundrazi, ai përqendrohej në krijimin e një shoqërie të shëndetshme ku njerëzit ishin të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe jo të izoluar. Kjo ishte e dukshme në mënyrën se si ndërtoheshin qytetet, duke mundësuar formimin e bashkësive rreth strukturave familjare dhe vlerave të fqinjësisë. Lejimi që korporatat zhvilluese t'i rrënojnë këto shoqëri dhe t'i mbyllin ato në blloqe ndërtimore të izoluara nuk përbën vetëm një krim kundër bukurisë dhe mjedisit, por edhe një tradhti ndaj historisë dhe stabilitetit qytetar. Ironia e dhimbshme është se ky përqafim i gabuar i një ideje të rreme të progresit po e shpërbën qytetin dhe shoqëritë e tij në botën myslimane me një ritëm më të shpejtë sesa në Perëndim. Qoftë për shkak se rendet politike postkoloniale në botën myslimane janë autokratike dhe jofunksionale, apo se shoqëria është mënjanuar nga vendimmarrja dhe gjendet nën trysni të vazhdueshme, urbanistët vazhdojnë t'ua imponojnë modernitetin këtyre qyteteve si një litar shpëtimi, ndonëse dita-ditës po bëhet gjithnjë e më e qartë se ai, në vend që t'i shpëtojë, po u shtrëngohet në qafë si një lak. Alternativa tjetër e kthimit te e vjetra dhe tradicionalja gjithashtu duket se nuk ofron një zgjidhje të kënaqshme, sepse jo vetëm që nuk arrin të përfaqësojë aspiratat kolektive dhe përfytyrimin që shoqëria ka për vetveten, por ashtu sikurse lëvizja e Klasicizmit të Ri është një guaskë e zbrazur nga kuptimi, e reduktuar thjesht në vlerën teknike të një botëkuptimi që po venitet dhe të strukturave tashmë të shpërbëra.

Arkitektura ka qenë gjithmonë një fushë që ka lartësuar vlerat më të epërme të njerëzimit, si dhe arritjet e tij më të mëdha. Në periudhat e saj të lulëzimit, ajo ishte në gjendje të kremtonte bukurinë, natyrën dhe dimensionet më të larta të qenies njerëzore, por ishte gjithashtu në gjendje të idealizonte pushtetin dhe të imponontе hegjemoninë. Historia na ka treguar se pikërisht tek kjo e fundit gjendet fundi i qytetërimit. Prandaj, ia kemi borxh vetes dhe botës t'i kundërvihemi valës së materializmit dhe shëmtisë, dobisë dhe ideologjisë, si dhe falsifikimit dhe kiçit. Të ndërtosh do të thotë të përjetësosh, dhe është përgjegjësia jonë të zgjedhim botëkuptimin dhe natyrën e asaj që do të ndërtojmë.



Cila është **urtësia e zbritjes** së **KURANIT** në **23**- vite?



Zbritja e Kuranit në mënyrë graduale është një fakt. Prandaj ajo që ne mund të bëjmë është të flasim mbi urtësitë e kësaj ngjarjeje, e cila përmban shumë urtësi, ndër të tjera:

1) Gradualizimi në kurimin e veseve të shoqërisë. Shoqëria ku zbriti Kurani duhej të ishte shembull për të gjithë njerëzimin deri në Ditën e Kiametit, por në kohën kur zbriti Libri i Shenjtë ajo shoqëri ishte e zhytur në vese prapanike, të cilat ishin bërë pjesë e karakterit të tyre. Zëvendësimi i këtyre veseve me vlera morale dhe virtyte të larta në një moment të vetëm binte ndesh me natyrën njerëzore dhe ata nuk do t'i përballonin dot të gjitha direktivat e ardhura me Kuranin Famëlartë. Prandaj për t'i çrrënjosur këto vese dhe për të ngulitur normat morale kuranore, Allahu (xh.sh.) e zbriti Kuranin gjatë 23 viteve, duke i paraqitur gradualisht gjykimet e reja në mënyrë që shoqëria të mund t'i zbatonte. Kështu na mëson edhe ne që të sillemi me njerëzit kur ata i ftojmë në fenë e Allahut (xh.sh).

2) Përforcimi i zemrës së Profetit (alejhisselam) dhe shokëve të tij. Këtë arsye Allahu (xh.sh) e shpjegon Vetë në një ajet kuranor ku ka thënë: **"E ata që nuk besuan thonë: "Përse të mos i ketë zbritur atij Kurani menjëherë?" (Ai nuk ka zbritur) kështu që me të të forcojmë zemrën tënde"** (Kuran, Surja Furkan, 25:32). Kjo ishte e nevojshme, sepse kauza islame kishte sfiduar një strukturë të mirëfilltë të mohimit dhe politeizmit e cila ishte formësuar ndër shekuj. Prandaj në dukje forca e myslimanëve mund të dukej e dobët, sidomos në periudhën e parë të Islamit, e cila quhet periudha e Mekës.

3) Lehtësimi i kuptimit dhe i mësimit përmendësh të Kuranit. Mësimi menjëherë përmendësh i një libri prej 600 faqesh do të ishte shumë i vështirë në mos i pamundur Për të lehtësuar këtë gjë Allahu e zbriti Kuranin pjesë-pjesë. Ai shprehet kështu në ajetin 106 të sures Isra: "Dhe Kuranin e ndamë pjesë-pjesë për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë".

4) Rregullimi i ngjarjeve dhe ndodhive. Sa herë që ndodhte një ngjarje për të cilën nevojitej udhëzim hyjnor, zbriste një ajet kuranor përmes të cilit bëhej vlerësimi i asaj ngjarjeje apo ndodhie dhe caktohej dispozita rreth saj. P.sh., ajetet 11-15 të sures Nur në lidhje me pastërtinë e Aishes (r.a), ajeti 118 i sures Teube ku tregohet pranimi i pendesës së Ka'b ibn Malik (r.a.), etj.

5) Vërtetimi se Kurani është fjalë dhe mrekulli e Allahut. Përmes përgjigjeve ndaj pyetjeve të bëra nga mosbesimtarët dhe ithtarët e librave të mëparshëm vërtetohej se Kurani është fjalë e Allahut dhe mrekulli e Tij.

Allahu di gjithçka më së miri.





INTERNETI NË SHTËPI: MUNDËSI DHE RREZIQE PËR FËMIJËT

Teknologjia mund të hapë dyert e dijes, por pa udhëzimin e duhur mund t'i ekspozojë fëmijët ndaj rreziqeve që ende nuk dinë t'i dallojnë.

Kur vendosni në dhomën e fëmijës një tavolinë studimi, një kompjuter dhe një lidhje interneti, a mendoni se e keni përmbushur detyrën tuaj si prindër?

Përgjegjësia juaj nuk përfundon me faktin që fëmija ka dhomën e vet, një tavolinë ku mund të mësojë, një kompjuter personal dhe qasje në internet. Edukimi i tij kërkon shumë më tepër sesa plotësimin e nevojave materiale. Ai ka nevojë për praninë, udhëzimin dhe kujdesin tuaj.

A mund ta konsiderojmë të edukuar një fëmijë vetëm sepse qëndron i qetë në dhomën e vet, nuk bën zhurmë dhe nuk ju shqetëson ndërsa ju shikoni televizor?

Interneti është një botë jashtëzakonisht e gjerë, që ofron mundësi të panumërta për të mësuar, për të zbuluar gjëra të reja dhe për të komunikuar. Por kjo botë, kur hyn në shtëpinë tonë përmes një ekrani, sjell me vete edhe sfida që kërkojnë vëmendje të veçantë.

Kur i japim fëmijës një pajisje me qasje të pakufizuar në internet dhe i themi: "Tani mund t'i bësh detyrat dhe të mësosh si të duash", duhet të pyesim veten nëse e kemi përgatitur atë për ta përdorur këtë mundësi me përgjegjësi.

Interneti nuk shërben vetëm për të bërë detyrat e shkollës. Përmes tij, fëmijët mund të përballen me miliona informacione, fotografi dhe video, disa të dobishme e të tjera të papërshtatshme për moshën e tyre. Nëse i lëmë vetëm përballë kësaj bote, pa u shpjeguar se si të dallojnë të vërtetën nga e pavërteta dhe të mirën nga e dëmshmja, a mund të presim që ata të bëjnë gjithmonë zgjedhjet e duhura?

Fëmijët e përvetësojnë teknologjinë me shpejtësi të madhe. Ata mund të mësojnë të përdorin një kompjuter, telefon apo aplikacion brenda një kohe të shkurtër. Megjithatë, aftësia për të përdorur teknologjinë nuk do të thotë se kanë edhe pjekurinë e nevojshme për të kuptuar çdo përmbajtje që shohin.

Shumë prindër mund të mos e dinë se çfarë shohin fëmijët në internet, me kë komunikojnë dhe sa kohë kalojnë para ekranit. Ndërkohë, fëmijët mund ta përdorin internetin jo vetëm për të mësuar, por edhe për argëtim, lojëra dhe komunikim me të tjerët.

Çfarë mund të gjejnë fëmijët në botën e internetit?

Me vetëm disa klikime, ata mund të përballen me përmbajtje jo të hijshme, pornografi, lojëra fati, gjuhë fyese, dhunë, mashtrime apo komunikime me persona të panjohur. Përmbajtje të tilla mund të shfaqen edhe pa u kërkuar drejtpërdrejt prej tyre.

Rreziqet nuk kufizohen vetëm te faqet e papërshtatshme. Fëmijët mund të bëhen viktima të bullizmit në internet, të manipulimit emocional, të shfrytëzimit apo të përpjekjeve për t'u fituar besimin nga persona me qëllime të këqija. Po ashtu, përdorimi i tepruar i pajisjeve digjitale mund të ndikojë në gjumin, përqendrimin, mësimet dhe marrëdhëniet familjare.

A është e arsyeshme që një fëmijë i vogël të përballet i vetëm me një botë kaq të gjerë dhe të ndërlikuar?



Interneti ndikon në mënyrën se si fëmijët e shohin veten, të tjerët dhe botën përreth. Përmbajtjet që shohin, njerëzit me të cilët komunikojnë dhe modelet që ndjekin mund të ndikojnë në formimin e tyre emocional, shoqëror dhe moral.

Kur fëmijët nuk kanë udhëzimin e duhur, mund të fillojnë të imitojnë sjellje të papërshtatshme, të krijojnë pritshmëri jorealiste për jetën ose të përvetësojnë modele marrëdhëniesh që bien ndesh me vlerat e familjes dhe të shoqërisë.

Megjithatë, zgjidhja nuk është t'i mbajmë fëmijët nën presion të vazhdueshëm apo t'ua ndalojmë çdo mundësi përdorimi të teknologjisë. Ndalimi i pakushtëzuar nuk i mëson domosdoshmërisht ata të bëjnë zgjedhje të mira. Ajo që nevojitet është një edukim i vazhdueshëm, i mbështetur te komunikimi, besimi dhe vendosja e kufijve të arsyeshëm.

Prindërit duhet të interesohen për atë që fëmijët bëjnë në internet, t'i dëgjojnë pa paragjykim dhe t'u shpjegojnë rreziqet në një mënyrë që përputhet me moshën dhe nivelin e tyre të kuptimit. Është e rëndësishme që fëmija të ndihet i sigurt për të kërkuar ndihmë kur përballet me diçka që e shqetëson, pa pasur frikë se do të qortohet apo ndëshkohet menjëherë.

Një tjetër hap i rëndësishëm është vendosja e rregullave të qarta për kohën para ekranit, përdorimin e pajisjeve dhe faqet që mund të vizitohen. Programet e kontrollit prindëror mund të ndihmojnë, por ato nuk mund ta zëvendësojnë komunikimin dhe praninë e prindit.

Prindërit duhet të jenë gjithashtu shembull në përdorimin e teknologjisë. Nëse kërkojmë që fëmijët të mos kalojnë gjithë kohën para ekranit, duhet të reflektojmë edhe mbi zakonet tona. Koha e kaluar së bashku, bisedat familjare, leximi, aktivitetet në natyrë dhe përfshirja në jetën shoqërore janë mënyra të rëndësishme për të krijuar një ekuilibër të shëndetshëm.

Nga këndvështrimi islam, edukimi i fëmijëve është një përgjegjësi që nuk kufizohet vetëm te ushqimi, veshmbathja dhe shkollimi. Ai përfshin edhe formimin moral, zhvillimin e përgjegjësisë dhe mësimin e dallimit mes asaj që është e dobishme dhe asaj që mund të sjellë dëm.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

"O ju që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga një zjarr, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët..." (Kuran, Surja Tahrim, 66:6).

Ky ajet na kujton përgjegjësinë për t'u kujdesur për familjen dhe për ta udhëzuar atë drejt së mirës. Në realitetin e sotëm, kjo përgjegjësi përfshin edhe edukimin e fëmijëve për përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë dhe mbrojtjen e tyre nga ndikimet e dëmshme.

Interneti është një mjet që mund të shërbejë për dije, zhvillim dhe komunikim. Por, si çdo mjet tjetër, vlera e tij varet edhe nga mënyra se si përdoret. Prandaj, nuk mjafton t'u japim fëmijëve pajisjet më të mira dhe qasje në informacion. Duhet t'u mësojmë edhe si të mendojnë, si të zgjedhin dhe si të mbrojnë veten.

Teknologjia mund t'i ndihmojë fëmijët të zbulojnë botën, por janë prindërit ata që duhet t'i përgatisin për ta përballuar atë me urtësi dhe përgjegjësi.

Në lidhje me ëndrrat

عَنْ عُبَادَةَ بْنِ الصَّامِتِ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ:
رُؤْيَا الْمُؤْمِنِ جُزْءٌ مِنْ سِتَّةٍ وَأَرْبَعِينَ جُزْءًا مِنَ النُّبُوَّةِ

"Ëndrra është një pjesë nga dyzet e gjashtë pjesët e profetësisë."
(Buhariu, Ta'bir, 26; Muslimi, Ru'ja, 6; Ebu Daudi, Edeb, 8; Tirmidhi, Ru'ja, 1)

I Dërguari i Allahut (a.s.), në këtë hadith të saktë, thotë se ëndrra është një pjesë nga dyzet e gjashtë pjesët e profetësisë. Kjo shprehje, nga aspekti i përmbajtjes dhe i domethënies, mund të kuptohet si një nga dyzet e gjashtë thellësitë e profetësisë, një nga dyzet e gjashtë pjesët e saj, një nga dyzet e gjashtë kuptimet që ajo shpreh dhe një nga dyzet e gjashtë parimet që ajo përmban në vetvete. Dijetarët hulumtues e kanë shpjeguar këtë hadith si vijon; Profeti Muhamed (a.s.), para se t'i vinte profetësia, për rreth gjashtë muaj, çështjet që lidhen me profetësinë i ka parë dhe i ka njohur përmes ëndrrave. Sipas transmetimit të Imam Buhariut, nëna jonë, Aishe (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.) i shihte ëndrrat e tij me qartësinë e dritës së mëngjesit dhe se ditën pasuese, ajo që kishte parë në ëndërr realizohej pikërisht ashtu siç ishte parë. Kjo fazë e ëndrrave zgjati plot gjashtë muaj. Duke qenë se profetësia zgjati njëzet e tre vjet, këta gjashtë muaj mund të konsiderohen si një nga dyzet e gjashtë pjesët e kohës së zbritjes së shpalljes. Në këtë periudhë, i Dërguari i Allahut (a.s.), kryesisht në Shpellën Hira dhe pranë Hadixhes së Nderuar (Allahu qoftë i kënaqur me të), përgatitej për profetësinë përmes ëndrrave dhe pas përfundimit të kësaj faze të ëndrrave, filloi zbritja e shpalljes.

Një aspekt tjetër të ëndrrave, i Dërguari i Allahut (a.s.) e shpjegon me këto fjalë: **"Në kohët e fundit (afër kijametit), gjërat më të sakta janë ëndrrat."** Përse? Sepse realiteti që qëndron pas ëndrrave, pra profetësia, tashmë nuk ekziston më. Nuk ka më takim të drejtpërdrejtë me të Dërguarin e Allahut (a.s.) në një dimension përtej kohës, dhe as marrje urdhrash prej tij. Për shembull, nuk ka më figura si Imam Rabbani, Imam Gazali, Shah Gejlani, Ahmet Rufai, Bediuzzaman Said Nursi (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata). Ne të gjithë jemi njerëz të zakonshëm. Nga ky këndvështrim, në botën e së vërtetës, gjërat që do të mund të merren nga 'dritarja e profetësisë' nuk mund t'i marrim drejtpërdrejt duke zgjatur dorën, nuk mund të kapërcejmë kohën dhe as të takohemi me profetët në një vend të caktuar. Ndërkohë, Xhunejd Bagdadi (Allahu qoftë i kënaqur me të) thotë: "Unë u takova drejtpërdrejt; ai më tha këto në ëndërr ose haptazi më dha këtë urdhër." Ja pra, ndërsa ne jemi të privuar nga të gjitha këto, e duke qenë se gjendja është e tillë, mes kaq shumë mëkateve dhe kaq shumë ngatërresave, Allahu na dhuron mirësitë e Tij përmes ëndrrave, ose përmes disa zemrave të pastra, i derdh ato mirësi brenda nesh nëpërmjet gjendjeve të zgjimit shpirtëror (**jakadha**), na bën të takohemi me shumë sahabë, evlija dhe njerëz të afërt me Allahun, në radhë të parë me vetë të Dërguarin e Allahut (a.s.). Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut(a.s.) thotë: **"Një nga gjërat që realizohen më saktë në kohët e fundit janë ëndrrat."** I Dërguari i Allahut (a.s.) këto ëndrra i quan 'mubeshirat'. Me termin 'mubeshirat' nënkuptohen gjërat që shprehin sihariq, përgëzim dhe lajm të mirë.

Në një periudhë të tillë, pra në një kohë kur tek shumë njerëz gjaku që rrjedh në damarë vlon në emër të pasioneve egoiste, fakti që besimtarët marrin një nxitje të tillë përbën padyshim një shfaqje të mëshirës hyjnore. E vërteta është se, ecja gjatë në këto rrugë të vështira do të ishte jashtëzakonisht e rëndë.



Megjithatë, pavarësisht të gjitha këtyre, besimtari nuk është njeri i ëndrrave. Sepse fëmijës nuk i jepet vazhdimisht karamele, pasi sheqeri i prish dhëmbët. Ndërkohë, njeriu duhet të ushqehet në mënyrë të shëndetshme, të ekuilibruar dhe të kujdesshme. Përndryshe, ashtu si në rastin e sheqerit, duke thënë: "Truri ynë ushqehet me glukozë..." etj., nëse vazhdon të hash pa kriter, mund të përballesh me sëmundje që zgjasin gjithë jetën. Pikërisht në të njëjtën mënyrë, nëse edhe ju e lidhni gjithçka me ëndrrat dhe nuk dilni dot përtej tyre, mbeteni një njeri i ëndrrave dhe ashtu vazhdoni. Edhe ajo që quajmë 'jakadha' është pikërisht e njëjtë në këtë aspekt.

Megjithatë, këto nuk janë kritere dhe rregulla që mund të konsiderohen si prova dhe argumente përkrah Kuranit dhe Sunetit, të cilat janë burimet reale të legjislacionit fetar. Qoftë ëndrrat dhe gjendjet e zgjimit shpirtëror (jakadha), qoftë përdorimi i xhindeve dhe shejtanëve, në disa raste - Allahu na ruajtë - mund ta devijojnë njeriun nga rruga e drejtë. Ai mund të devijojë dhe të humbasë edhe pikërisht në fazën kur duhej të fitonte. Për shembull, Gulam Ahmed ka rënë në një pengesë të tillë dhe ka humbur. Meqë në jogizëm dhe hinduizëm ai ishte në një nivel të avancuar sa i përket fitimit të fuqisë së shpirtit përmes vetvetes, ai zgjodhi ta shfaqte epërsinë e Islamit përmes kësaj rruge. Madje, duke e futur gjuhën deri në fyt, u përpoq të qëndronte gjashtë muaj pa ngrënë asgjë. Gjoja, me këtë ai synonte të tregonte epërsinë e Islamit ndaj brahmanëve dhe budistëve. A është kjo mënyra për ta shpjeguar Islamin? Patjetër që jo. Si përfundim, shohim se më vonë Gulam Ahmedi ka bërë, njëri pas tjetrit, pohimet: "Unë jam Mehdiu, unë jam imami i pritur, unë jam profet" dhe në fund fare, ka thënë: "Unë jam Allahu."

Ja pra, çështje të tilla si përdorimi i xhindeve dhe shejtanëve, veprimi vetëm sipas ëndrrave dhe mbështetja vetëm te gjendjet e zgjimit shpirtëror (jakadha), zakonisht fillojnë në mënyrë të pafajshme, brenda ndjenjave dhe mendimeve islame... fillojnë, por pastaj sheh se ke dalë nga boshti i drejtë.

Ajo që na takon neve është t'i përmbahemi Kuranit dhe Sunetit. Për shembull, edhe sikur të shëtisnit nëpër qiej, edhe sikur të takoheshit me të Dërguarin tonë (a.s.) në një dimension përtej kohës, edhe sikur të mbeteshit ballë për ballë me shfaqje të ndryshme të Madhërisë Hyjnore, të gjitha këto, përballë jetesës së Sunetit, nuk zënë vend as sa lëvozhga e një arre.

Prandaj, le të mbetemi myslimanë të thjeshtë, le të ecim mbi tokë. Le të themi: "Të jesh ushtar i thjeshtë është më mirë sesa të jesh me gradë", dhe le të jemi njerëz mes njerëzve. Kur Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të) u përgëzua me fjalët: "Ti e ke kënaqur Profetin. E ke kënaqur Ebu Bekrin. Do të hysh në Xhenet, e atje do të kesh çadrën tënde", ai buzëqeshi dhe tha: "Do të isha shumë i kënaqur sikur të dilja nga kjo botë ashtu siç kam hyrë." Çdo besimtar duhet të mendojë në këtë mënyrë.

Jetoni me ndjenja krejtësisht të pastra. Nëse me një përpikëri të jashtëzakonshme thoni "Kurani dhe Suneti", nëse parimet e fesë sonë dhe bazat e saj racionale i bëni parime të jetës, Allahu nuk ju lë vetëm. Ai ju dhuron edhe ato mirësi që ua ka dhuruar evlijave të Tij.

Si përfundim, mund të themi se, përtej asaj që thuhet në Kuran dhe Sunet, nuk ka mbetur më diçka shtesë për t'u marrë në emër të fesë. Ëndrrat dhe gjendjet e zgjimit shpirtëror (jakadha), nëse besohen në mënyrë që nxisin zellin dhe gjallërinë shpirtërore në adhurime, mund të merren në konsideratë, për sa kohë nuk bien ndesh me Kuranin dhe Sunetin. Allahu e di më së miri!

Të menduarit globalisht dhe pasojat e tij negative



Në këtë botë të gjerë ndodhin shumë ngjarje kozmike, politike dhe shoqërore që ndikojnë te njeriu, secili sipas natyrës së tij dhe afërsisë me ngjarjen. Shumica e njerëzve i përjetojnë këto ngjarje, por me kalimin e kohës interesi për to zbehet. Megjithatë, ka disa persona te të cilët ngjarja lë gjurmë të thella dhe mbetet me ta përgjithmonë, ose të paktën për një kohë të gjatë.

Gjithashtu, ekziston një grup njerëzish që nuk e kanë përjetuar ngjarjen as në aspektin kohor, as në atë hapësinor, dhe nuk janë prekur drejtpërdrejt prej saj; por megjithatë, ajo është bërë pjesë e interesave të tyre, për shkak të një shtyse besimore, humane apo thjesht nga kureshtja.

Këto interesa ndryshojnë sipas mënyrës së të menduarit të njerëzve; ka një kategori që kujdeset vetëm për përfitimet e drejtpërdrejta individuale dhe të përditshme, me një horizont të ngushtë që rrotullohet rreth egos dhe nevojave bazë.

Ekziston një kategori shoqërore, interesi i së cilës shtrihet më gjerë, duke përfshirë familjen, fisin ose shoqërinë lokale, dhe veprimtaria e saj zhvillohet brenda një mjedisi gjeografik e shoqëror të kufizuar.

Kategoria për të cilën po flas është ajo që mendon globalisht, që e tejkalon interesin e kufijve gjeografikë dhe të mjedisit të drejtpërdrejtë, duke jetuar me shqetësimet e një umeti të tërë ose të një bote të tërë. Ajo përqafon çështje të mëdha ideologjike, besimore dhe politike, dhe jeton më tepër në botën e ideve dhe teorive sesa në botën e njerëzve dhe gjërave materiale që e rrethojnë.

Kjo kategori konsiderohet disi ideale dhe pozitive, me kusht që ky interes të mos mbizotërojë mbi përfitimet e saj personale ose mbi mbi përmbushjen e detyrimeve të saj fetare.

Shkaku i hyrjes ose i bashkimit të njeriut në këtë kategori lidhet me leximin enciklopedik, me njohjen e gjerë dhe me zhytjen në librat e historisë dhe filozofisë, si dhe me studimin e zhvillimeve dhe të jetës së kombeve; gjë që e ngre njeriun nga realiteti i një qyteti apo atdheu në horizonte të gjera. Po ashtu, kjo lidhet me ekzistencën e një besimi të thellë te ky njeri. Kur individi ndien lidhjen e akides (besimit), e sheh veten si pjesë e një trupi të vetëm që shtrihet nëpër kohë dhe hapësirë. Prandaj, kujdesi i muslimanit për atë që ndodh me vëllezërit e tij muslimanë në botë është për shkak të vëllazërisë në fe dhe në zbatim të urdhrit kuranor. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Besimtarët dhe besimtaret janë miq për njëri-tjetrin."**: (Kuran, Surja Teube, 9:71)

Ka ardhur nga Profeti (a.s.): **"Shembulli i besimtarëve në dashurinë e tyre, mëshirën e tyre dhe dhembshurinë e tyre është si trupi: kur një pjesë e tij sëmuret, i gjithë trupi reagon me pagjumësi dhe ethe."** (Trans. Buhariu 611)

Përveç kësaj, krizat e mëdha dhe përplasjet civilizuese - si thyerjet e umetit, humbjet e tij, apo ndryshimet e mëdha drejt hapjes së pakontrolluar dhe largimit nga feja, e zgjojnë fuqishëm këtë kategori dhe i shtyjnë të reflektojnë mbi pasojat e largëta. Këto ngjarje e trazojnë këtë kategori dhe i shtyjnë të mendojnë për pasojat afatgjata. Kështu, njeriu shndërrohet në një mendje të mbushur me brengë dhe përgjegjësi, që jeton me shqetësimin e së ardhmes dhe me barrën e fateve të mëdha të umetit.

Ky realitet mbart një kosto të madhe psikologjike dhe shoqërore. Njëra prej tyre është ajo që quhet "tjetërsim shoqëror dhe real", ku kjo kategori jeton një lloj "vetmie" mes bashkëmoshatarëve dhe mjedisit të afërt; sepse mënyra e tyre e të menduarit i largon nga bisedat e thjeshta të përditshme të njerëzve. Kjo shpesh i bën të duken si të larguar ose të izoluar. Po ashtu, përqendrimi i vazhdueshëm në çështje të mëdha - si luftërat, fatkeqësitë natyrore, krizat politike - krijon një ndjenjë të përhershme pafuqie, sepse individi nuk ka mjete të drejtpërdrejta për t'i ndryshuar këto ngjarje madhore. Kjo mund të sjellë zhgënjim, pesimizëm, madje edhe lodhje e thellë mendore. Një mendje që nuk gjen qetësi, e cila rri e mbushur me mendime për fatin e kombeve dhe brezave, humbet paqen e brendshme dhe aftësinë për të shijuar kënaqësitë e thjeshta e të lejuara të jetës; dhe mbetet kështu në një gjendje alarmi mendor dhe brengash të vazhdueshme.

Siç ka thënë edhe poeti i madh **Abu al-Tayyib al-Mutanabbi:**

Brenga e shkatërron trupin e fortë, e thinj ballin e fëmijës dhe e plak para kohe.

Kjo prirje shpesh çon në neglizhimin e detyrimeve të drejtpërdrejta që i janë ngarkuar njeriut. Mund të ndodhë që individi të niset me gjithë energjinë e tij për të përmirësuar gjendjen e umetit ose për të hartuar teori për të, ndërkohë që lë pas dore detajet e jetës së tij personale, familjen e tij, apo edhe detyrimet profesionale të përditshme. Në këtë rast i përshtatet thënia: "Shpëton botën, por humb shtëpinë." Kjo bie ndesh me atë që kërkon feja, e cila e vendos përparësinë te kujdesi për më të afërtit. Allahu i Madhëruar thotë: **"O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato."** Et-Tahrim, 66:6

Dhe Profeti (a.s.) ka thënë: *"Me të vërtetë, vetja jote ka të drejtë mbi ty, familja jote ka të drejtë mbi ty, dhe Zoti yt ka të drejtë mbi ty; prandaj jepi secilit të drejtën e tij."* (Trans. Buhariu 1968)

Zgjidhja më e bukur dhe më e përshtatshme është të jemi mesatarë, pa teprime dhe dhe pa lënë pas dore detyrimet. Të mos zhytemi e të humbasim në ndjekjen e çdo gjëje që ndodh në botë, duke lënë pas dore detyrimet tona të drejtpërdrejta; por as të bëhemi egoistë që mendojmë vetëm për veten dhe interesat tona personale.

Allahu i Madhëruar i udhëzoftë të gjithë muslimanët drejt asaj që Ai e do dhe është i kënaqur me të.

Roli i figurës së gruas në epokën profetike

Kur i kthehemi studimit të jetës së Profetit Muhamed (a.s.), gabimi më i madh do të ishte ta shihnim atë thjesht si një seri ngjarjesh historike të lëna pas në kohë apo si një kronikë të largët. Përkundrazi, jeta e tij është një model i gjallë sjelljeje, një burim i papërsëritshëm udhëzimi, që flet me të njëjtën fuqi edhe për sfidat tona sot. Në këtë kuadër, ekziston një mendësi e gabuar, që supozon se historia islame është ndërtuar dhe shkruar vetëm nga burrat. Mirëpo, kur thellohemi pa paragjykime në burimet e mirëfillta teologjiko-historike, zbulojmë rolin kyç që ka luajtur gruaja në shoqëritë islame. Vërejmë se ajo nuk është një figurë periferike apo si një hije prapa burrit.

Gratë në epokën profetike kështillonin, ndihmonin, edukonin, transmetonin dituri, merrnin pjesë në vendimarrje publike dhe spikatën në momente krize, duke lënë gjurmë të pacenueshme që provojnë se roli i gruas nuk mund të reduktohet vetëm brenda katër mureve të shtëpisë.

Që në hapat e parë të shpalljes hyjnore, Islami i dha figurës femërore dinjitet, liri dhe pjekuri intelektuale e shoqërore, që përmbysi konceptet e prapambetura të kohës. Në një ambient ku gruaja trajtohej si pronë apo pa të drejtë fjale, mesazhi profetik i riktheu asaj dinjitetin e lindur njerëzor të barabartë me burrin, të drejtën e pronës, lirinë e mendimit dhe barazinë shpirtërore e morale përpara Zotit. Kjo pjekuri shoqërore nuk mbeti një teori abstrakte, por u jetësua përmes figurave të mëdha historike të epokës profetike.

Kur vëzhgojmë rrugëtimin e profetëve gjatë gjithë historisë njerëzore, vëmë re se prapa çdo misioni të madh qëndron figura e fuqishme e një gruaje. Ne shohim shembullin e Merjemes (alejhasselam), nënës së Profetit Isa (a.s.), e cila mbajti një barrë të rëndë shoqërore e shpirtërore dhe që Zoti e solli në jetë si simbol të pastërtisë dhe përkushtimit. Shohim shembullin e Haxheres (a.s.), nënës së Ismailit (a.s.), e cila mes shkretëtirës dhe vetmisë, u ballafaqua me sprova të vështira, dhe duke i kaluar ato me sukses, u bë simbol i qëndresës, besimit të patundur dhe veprimit energjik, gjurmët e së cilës besimtarët i ndjekin ende sot gjatë riteve të Haxhit.

Kjo trashëgimi u konfirmua edhe në jetën e Profetit (a.s.), ku formimi i vetë personalitetit të tij nisi me përkujdesjen femërore. Profeti (a.s.) lindi jetim nga i ati, prandaj dashuria, edukimi dhe ngrohtësia e parë buruan nga nëna e tij, Aminja, e më tej nga nëna e qumështit Halimja, e cila e rriti me përkushtim në vitet e para të fëmijërisë. Butësia, dhembshuria dhe ndjeshmëria, që karakterizuan më vonë sjelljen e tij ndaj të gjithë njerëzimit, u brumosën pikërisht nga kjo dashuri amore.

Figura femërore u bë gurthemel edhe në një nga çastet më kritike të historisë islame: momentin e nisjes së procesit të shpalljes së parë në shpellën Hira. Kur Profeti (a.s.) u përball me peshën e madhe të profetësisë dhe u kthye në shtëpi i tronditur dhe duke u dridhur. Ai nuk kërkoi mbështetjen e burrave të fisit apo të parisë së Mekës, por u kthye në shtëpinë e tij, tek bashkëshortja e tij, Hatixhja (r.anha). Tashmë një grua e pjekur me shumë eksperiencë, ajo e dëgjoi bashkëshortin e saj me shumë kujdes. Me inteligjencën dhe urtësinë e saj, ajo e dëgjoi me vëmendje, e qetësoi, i dha siguri emocionale dhe u bë strehë e palëkundur për të. Ajo provoi se roli i gruas në momentet më të vështira është ai i këshilltares strategjike dhe i shtyllës shpirtërore.

Hatixhja (r.anha) ishte personi i parë në tokë që besoi në misionin e tij. Kur analizojmë profilin e saj, shohim se nuk ishte thjesht një grua shtëpiake, por një nga sipërmarrëset më të suksesshme e më të mençura të kohës.

Me kalimin e viteve, përmasa e kontributit femëror mori një trajtë të lartë intelektuale dhe akademike përmes figurës së Aishes (r.anha). Aishja nuk ishte thjesht dëshmitare e jetës familjare të Profetit (a.s.), por u shndërrua në një nga mendjet më të mëdha akademike. Ajo mori titullin teologe dhe mësuese të bashkësisë së myslimanëve. Transmetoi mbi dy mijë rrëfime profetike, ndriçoi normat e fesë dhe interpretoi me saktësi Kuranin Famëlartë. Sahabët më të mëdhenj

e më të ditur, kur ndodheshin përballë dilemave të ndërlikuara juridike apo teologjike, shkonin te Aishja (r.a.) për të kërkuar mendim dhe fetva. Përmes saj, Islami u tregoi shekujve se 'grua besimtare' do të thotë mendje e arsimuar dhe autore e diturisë që kontribuon në formësimin e shëndetshëm të mendësisë të të gjithë shoqërisë.

Po ashtu, kur flasim për të drejtën e zërit të gruas, historia islame na njeh me shembullin e Haules (r.a.), një grua e zakonshme që ngriti zërin kundër një padrejtësie familjare dhe e parashtroi çështjen e saj te Profeti (a.s.). Zoti i Madhëruar e dëgjoi shqetësimin e saj nga lartësitë e qiejve dhe zbriti një kapitull të tërë të Kuranit Fisnik për të mbrojtur dinjitetin e saj. Kjo provon se në vizionin islam, zëri i gruas për të drejtën dhe drejtësinë respektohet e dëgjohet në nivelin më të lartë hyjnor, si dhe ajo gjen hapësirën e nevojshme në shoqërinë e ndërtuar me duart e Profetit Muhamed (a.s.) që të shprehë shqetësimet e saj.

Qartësisht, Profeti (a.s.) nuk e përjashtoi kurrë gruan nga asnjë fushë e jetës.Ne shohim shembullin e Zejneb bint Xhahsh (r.a.), e cila punonte me dorën e saj artizanatin për të fituar të ardhura e për t'u dalë në ndihmë të varfërve. Ajo u bë shembull i pavarësisë dhe vullnetarizmit social.

Profeti Muhamed (a.s.) nga lindja e deri në frymëmarrjen e fundit, ku sytë i mbylli pikërisht nën kujdesin dhe dashurinë e Aishes (r.a.), pra në krahët e saj, gruan e pati bashkëudhëtare të pandashme të jetës së tij.

Po ashtu, kontributi i grave shtrihej në çdo sferë publike: nga mjekësia dhe infermieria në fushëbetejë, te veprimtaria ekonomike e bamirëse, e deri te qëndresa heroike e Sumejes (r.a.), e cila u bë dëshmorja e parë në Islam.

Por ne, për ta mbyllur, do të ndalemi tek një shembull atipik, që na tregon se roli i gruas, si zë me peshë në vendimmarrjen publike, konfirmohet në mënyrë të shkëlqyer gjatë Marrëveshjes së Hudejbijes.

Kjo është ngjarja e Marrëveshjes së Hudejbijes. Kur myslimanët u penguan të kryenin Umren e tyre të parë, Profeti (a.s.) nënshkroi një marrëveshje paqeje. Kontentin e marrëveshjes sahabët e vlerësuan si tepër të rëndë, pavarësisht se myslimanët dukeshin në epërsi.


Por Profeti (s.a.s.) nuk hoqi dorë dhe u kërkoi atyre të prisnin kurbanët dhe të qethnin flokët për të dalë nga ihrami, që do të thoshte se po ktheheshin pa bërë umre. Të përhumbur nga mërzitja dhe sprova e momentit, sahabët hezituan të reagonin menjëherë.

Profeti (a.s.) u pikëllua nga kjo pamje. Duhej të vepronte në një mënyrë të tillë që t'i bindte ata me urtësi, pa u thyer zemrën. Hyri në çadër, ku gjendej bashkëshortja e tij, Umu Seleme (r.a.). Në këtë situatë, Profeti Muhamed (a.s.) u konsultua me bashkëshorten e tij dhe ajo, me një intuitë dhe urtësi të hollë politike e psikologjike, i dha një këshillë gjeniale: i tha të dilte jashtë pa folur me askënd, të bente kurbanin e tij dhe të qethte flokët i pari. Profeti (a.s.) nuk e anashkaloi mendimin e saj sepse ishte grua, as nuk pretendoi se autoriteti i tij si burrë apo udhëheqës do të zbehej duke dëgjuar një grua. Ai e vlerësoi këshillën dhe e zbatoi atë menjëherë. Kur sahabët panë veprimin e Profetit (a.s.), i ndoqën menjëherë hapat e tij dhe kriza u zgjidh. Ky qe një moment historik për pozitën e gruas.

Ky model i epokës profetike shërben sot si udhërrëfyes i qartë për gruan besimtare bashkëkohore. Ai na tregon se besimi dhe përkushtimi fetar nuk janë pengesë, por shtytësit më të mëdhenj për arsimim, zhvillim intelektual dhe emancipim shoqëror. Sot, gruaja besimtare thirret nga vetë tradita e saj profetike që të jetë e arsimuar, të ndërtojë dhe të shprehë mendimin e saj, të jetë aktive në komunitet, në shëndetësi dhe në çdo hap të jetës publike.

Të gjitha këto fakte na çojnë në konkluzionin e pamohueshëm se kur studiojmë jetën e Profetit (a.s.) dhe historinë islame, gratë kanë qenë dhe mbeten arkitektet e shpirtit, edukueset e brezave dhe partneret e barabarta në ndërtimin e të mirës. Sot, gruaja besimtare nuk ka pse të ndihet e ndarë mes besimit të saj dhe zhvillimit shoqëror apo arsimor. Siç na ka mësuar Profeti (a.s.), edukimi i vajzave është dera e parë e fisnikërimit të një populli dhe një çelës që hap dyert e xhenetit.

Por gruaja ka nevojë edhe që të mbështetet dhe t'i jepet hapësirë për aktivitetin e saj. Po e mbyll fjalën time me thënien e vyer të Profetit Muhamed (a.s.): "Më i miri ndër ju është ai që është më i miri për familjen e tij."



HISTORIA E DY pronarëve të kopshteve



Një nga veçoritë madhështore të Kuranit është se ai nuk na rrëfen histori thjesht për të na informuar mbi të kaluarën, por për të na ndihmuar të kuptojmë të tashmen dhe të ndërtojmë të ardhmen. Pikërisht për këtë arsye, Allahu i Madhëruar, në Suren Kehf na paraqet historinë e dy pronarëve të kopshteve, një histori e cila, megjithëse është shpallur më shumë se katërmbëdhjetë shekuj më parë, duket sikur flet drejtpërdrejt për njeriun e kohës sonë.

Allahu thotë:

وَاضْرِبْ لَهُمْ مَثَلًا رَجُلَيْنِ جَعَلْنَا لِأَحَدِهِمَا جَنَّتَيْنِ مِنْ أَعْنَابٍ وَحَفَفْنَاهُمَا بِنَخْلٍ وَجَعَلْنَا بَيْنَهُمَا زَرْعًا

"Dhe jepu atyre shembullin e dy burrave; njërit prej tyre i dhamë dy kopshte me rrush, i rrethuam me palma dhe mes tyre vendosëm ara." (Kuran, Surja Kehf, 18:32)

Allahu nuk e qorton pasurinë. Nuk e ndalon pasurinë. Nuk e dënon begatinë. Përkundrazi, është Allahu që e jep atë. Islami nuk është fe e varfërisë së detyruar, por fe e ekuilibrit. Problemi nuk fillon kur pasuria hyn në duart tona, por kur ajo hyn në zemrën tonë.

Dijetarët kanë thënë një fjalë të bukur: "Pasuria është shërbëtor i mirë, por zotëri shumë i keq."

Ky njeri kishte gjithçka që shumë njerëz do ta ëndërronin. Kopshtet e tij prodhonin pa ndërprerje, uji rridhte, veprimtaria e tij lulëzonte dhe çdo gjë ecte sipas dëshirës së tij. Por pak nga pak, pa e kuptuar, ai filloi të ndërtonte një idhull të ri në zemrën e vet. Nuk ishte një idhull prej guri apo druri, por një idhull edhe më i rrezikshëm: vetvetja.

Ai filloi ta shihte veten si shkakun kryesor të suksesit të tij. Filloi të besonte se gjithçka që kishte ishte fryt vetëm i aftësive të tij. Kjo

është sëmundja e çdo kohe. Është sëmundja e njeriut që e harron Allahun kur çdo gjë shkon mirë.

Pastaj Kurani na sjell një fjali të shkurtër, por tepër të rëndë:

وَدَخَلَ جَنَّتَهُ وَهُوَ ظَالِمٌ لِنَفْسِهِ

"Dhe ai hyri në kopshtin e vet duke i bërë padrejtësi vetes." (Kuran, Surja Kehf, 18:35)

Vini re, o besimtarë, Allahu nuk tha se po i bënte padrejtësi shokut të tij, por vetes së tij. Sepse njeriu që largohet nga Allahu është armiku i parë i vetes së tij. Sa njerëz shohim sot që nga jashtë duken të suksesshëm, por nga brenda janë të rrënuar? Kanë gjithçka, por nuk kanë qetësi. Kanë pasuri, por u mungon rehatia.

Pastaj ai thotë:

مَا أَظُنُّ أَنْ تَبِيدَ هَذِهِ أَبَدًا

"Nuk besoj se kjo do të zhduket ndonjëherë." (Kuran, Surja Kehf, 18:35)

Sa e njohur tingëllon kjo fjali edhe sot! Ndoshta jo me fjalë, por me mendësi. Sa njerëz jetojnë sikur gjithçka do të zgjasë përgjithmonë? Sa njerëz planifikojnë çdo gjë për dhjetëra vite, por nuk planifikojnë asnjë ditë për Ahiretin? Sa njerëz kujdesen për investimet e tyre, por e lënë zemrën e tyre të varfërohet?

Në fakt, njeriu modern jeton me një iluzion shumë të madh: iluzionin e kontrollit. Mendon se kontrollon jetën, shëndetin, pasurinë, të ardhmen dhe sigurinë e vet. Por Allahu na kujton vazhdimisht se ne jemi krijesa të dobëta. Një analizë mjekësore mund t'ia ndryshojë planet e një jete të tërë. Një aksident mund të ndodhë brenda sekondave. Një krizë ekonomike mund të rrënojë punën e shumë viteve. Një telefonatë mund ta ndajë njeriun nga gjithçka që ka dashur.

Ky njeri vazhdoi edhe më tej dhe tha:

وَمَا أَظُنُّ السَّاعَةَ قَائِمَةً وَلَئِنْ رُدِدْتُ إِلَى رَبِّي لَأَجِدَنَّ خَيْرًا مِنْهَا مُنْقَلَبًا

"Nuk besoj se do të ndodhë Kiameti, por edhe nëse kthehem te Zoti im, do të gjej diçka më të mirë." (Kuran, Surja Kehf, 18:36)

Ky është kulmi i vetëmashtrimit. Kur njeriu fillon ta shohë begatinë e kësaj bote si garanci të suksesit në botën tjetër. Dijetarët kanë thënë se një nga sprovat më të mëdha është që njeriu ta interpretojë rehatinë e dynjasë si shenjë automatike të kënaqësisë së Allahut.

Por Allahu na mëson ndryshe. Ka njerëz që Allahu i do dhe dhe i vë në sprovë (propozim: Ka njerëz që Allahu i do dhe i vë në sprovë). Ka njerëz që Allahu u jep pasuri dhe ka të tjerë që Allahu i privon nga pasuria.

Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë:

إِنَّ لِكُلِّ أُمَّةٍ فِتْنَةً، وَإِنَّ فِتْنَةَ أُمَّتِي الْمَالُ

"Për çdo umet ka një sprovë dhe sprova e umetit tim është pasuria."

Sa aktual është ky hadith! Shumë prej nesh nuk bien në mëkate të mëdha, por bien në robërinë e dynjasë. E gjithë dita sillet rreth fitimit, punës, blerjes, krahasimit dhe grumbullimit.

Por Allahu, nga mëshira e Tij, vendos pranë këtij njeriu një shok besimtar. Kjo është një prej dhuntive më të mëdha që Allahu mund t'i japë dikujt: një mik që ta kujton Allahun.

Shoku i tij nuk e pati zili. Nuk e mallkoi. Nuk u gëzua për gabimin e tij. Përkundrazi, e këshilloi me butësi.

أَكَفَرْتَ بِالَّذِي خَلَقَكَ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ مِنْ نُطْفَةٍ ثُمَّ سَوَّاكَ رَجُلًا

Ai i tha: "A po e mohon Atë që të krijoi nga dheu, pastaj nga një pikë uji e më pas të bëri njeri?" (Kuran, Surja Kehf, 18:37)

Sa herë që arroganca hyn në zemër, ilaçi është të kujtojmë origjinën tonë. Nga kemi ardhur? Nga një pikë e dobët uji. Çfarë do të bëhemi? Do të kthehemi në tokë. Dhe ndërmjet këtyre dy momenteve, Allahu na ka dhënë një periudhë të shkurtër që quhet jetë.

Prandaj, Hasan el-Basri ka thënë: "O biri i Ademit, ti je vetëm një numër ditësh; sa herë që kalon një ditë, ikën një pjesë e jotja."

Më pas, shoku besimtar i mësoi një mësim shumë të rëndësishëm: **"Sikur, kur hyre në kopshtin tënd, të kishe thënë: Ma sha Allah, la kuvvete illa billah."** (Kuran, Surja Kehf, 18:39)

Sa e bukur është kjo fjali. Është një gjendje e zemrës. Do të thotë: çdo mirësi që kam është prej Allahut dhe asnjë forcë nuk e zotëroj vetë.

Pastaj erdhi momenti që ndryshoi gjithçka.

Allahu e shkatërroi kopshtin.

Ajo që njeriu ndërton për vite, Allahu mund ta marrë brenda çastit. Jo sepse Allahu dëshiron ta dëmtojë njeriun, por sepse dëshiron ta zgjojë atë.

Në atë moment, ai filloi të rrihte duart nga pendimi dhe tha:

يَا لَيْتَنِي لَمْ أُشْرِكْ بِرَبِّي أَحَدًا

"Ah, sikur të mos i kisha bërë askënd shok Zotit tim." (Kuran, Surja Kehf, 18:42)

Kjo histori nuk flet vetëm për kopshte. Kopshti i dikujt sot mund të jetë biznesi i tij. Mund të jetë shtëpia e tij. Mund të jetë profesioni i tij. Mund të jetë fama e tij. Mund të jetë pozita e tij. Mund të jetë edhe vetë shëndeti i tij.

Lusim Allahun e Madhëruar të na dhurojë zemra mirënjohëse, gjuhë që e përmendin Atë dhe jetë të mbushura me bereqet, përulësi dhe devotshmëri. Amin.

Durimi, **një virtyt që sjell shpërblim**



Durimi është aftësia për të ruajtur ekuilibrin përballë ndryshimeve dhe situatave të vështira, materiale apo shpirtërore. Ai na ndihmon të përballojmë dëshirat e forta, dhimbjet, vështirësitë dhe vuajtjet me gjakftohtësi, duke i mbajtur ndjenjat brenda kufijve të përcaktuar nga arsyeja dhe feja.

Durimi është një nga shtyllat e moralit të bukur, një virtyt i madh dhe çelës i qetësisë e i lumturisë. Ai na mëson të mos e humbasim ekuilibrin përballë ngjarjeve të pakëndshme që na shkaktojnë dhimbje, por t'i përballojmë ato me besim dhe mbështetje te Allahu.

Edhe në çështjen e durimit, profetët e Allahut kanë dhënë shembuj të jashtëzakonshëm dhe kanë fituar ndihmën e Tij. Prandaj, ata duhet të jenë shembujt tanë. Durimi mund të jetë i vështirë në këtë botë, por shpërblimi i tij në ahiret është i madh.

Ata që e përballojnë sprovën me durim shpresojnë të fitojnë kënaqësinë e Allahut dhe shpërblimin e Xhenetit, vendbanimit të përjetshëm. Kujtimi i mëshirës, urtësisë dhe shpërblimit hyjnor, si dhe përpjekja për t'iu përmbajtur urdhrave dhe ndalesave të Allahut, na e lehtësojnë durimin.

Një nga kushtet e durimit është që njeriu ta tregojë atë që në çastin kur përballet me sprovën. Durimi i ushtruar në kohën e duhur ka rëndësi të veçantë.

Durimi zë një vend të rëndësishëm në fenë tonë

dhe lidhet ngushtë me virtytet e moralit. Në Kuranin Famëlartë thuhet:

"O ju që keni besuar! Bëni durim, qëndroni të palëkundur dhe jini të përgatitur..." (Kuran, Surja Ali Imran, 3:200).

Ky ajet na mëson se durimi dhe qëndrueshmëria janë ndër kushtet e rëndësishme të suksesit. Njeriu që përballet me sprova dhe vështirësi nuk mund t'i kapërcejë ato pa durim, këmbëngulje dhe mbështetje te Allahu.

Mesazhi i ajetit mund të përmblidhet kështu: suksesi kërkon durim dhe qëndrueshmëri. Në fund të sures Ali Imran, besimtarët udhëzohen të qëndrojnë të palëkundur dhe të jenë të vetëdijshëm për Allahun, në mënyrë që të arrijnë shpëtimin.

"Ne do t'ju sprovojmë me diçka nga frika, uria, pakësimi i pasurisë, i njerëzve dhe i të lashtave. Prandaj, përgëzoji të duruarit." (Kuran, Surja Bekare, 2:155).

Në këtë ajet përmenden disa nga sprovat me të cilat mund të përballen besimtarët: frika, uria dhe humbjet materiale e njerëzore. Përballë tyre, besimtari përpiqet të ruajë durimin, besimin dhe mbështetjen te Allahu, pa e humbur shpresën.

"Vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë." (Ez-Zumer, 39:10).

Premtimi për shpërblim të pakufishëm tregon vlerën e madhe të durimit përballë sprovave. Durimi është një virtyt që kërkon forcë të brendshme, besim dhe këmbëngulje.

"Kush bën durim dhe fal, pa dyshim, kjo është ndër çështjet më të vendosura." (Esh-Shura, 42:43).

Durimi dhe falja nuk janë gjithmonë të lehta. Ato kërkojnë pjekuri dhe forcë morale. Njerëzit që arrijnë t'i përballojnë vështirësitë pa humbur drejtimin, zhvillojnë virtyte të larta dhe bëhen shembull për të tjerët.

Ebu Jahja Suhejb ibn Sinani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

"Është e çuditshme çështja e besimtarit! Çdo gjendje që e godet, është e mirë për të, dhe kjo nuk ndodh me askënd tjetër përveç besimtarit. Nëse i vjen një e mirë, ai falënderon Allahun dhe kjo është mirë për të; nëse e godet një e keqe, ai bën durim dhe kjo është mirë për të." (Muslimi, Ez-Zuhd, 64).

Në kohën e Profetit (a.s.), idhujtarët e Mekës u shkaktonin muslimanëve vështirësi dhe padrejtësi të mëdha. Megjithatë, Profeti (a.s.) dhe shokët e tij i nxitnin besimtarët të qëndronin të duruar, duke u kujtuar vlerën e durimit dhe shpërblimin e tij. Të jetosh me shpresë, të gjesh të mirën dhe të përpiqesh për lumturi janë dëshira të natyrshme të njeriut. Askush nuk dëshiron me vetëdije të keqen, vuajtjen dhe pakënaqësinë, sepse ato bien ndesh me natyrën njerëzore të krijuar nga Allahu.

Megjithatë, kjo botë është e mbushur me vështirësi, probleme, përgjegjësi dhe kundërshti. Kur njeriu arrin ta dallojë të drejtën mes këtyre kundërshtive, të gjejë shpresë në vështirësi dhe të mos mposhtet nga e keqja, ai përjeton një mirësi të madhe nga Allahu. Nëse këtë mirësi do ta përmblidhnim me një fjalë, ajo do të ishte Imani. Besimi na ndihmon të ruajmë maturinë dhe qëndrueshmërinë përballë sprovave. Ai krijon një lidhje shpirtërore me vullnetin dhe urtësinë e Allahut, duke na dhënë forcë për t'u përballur me vështirësitë e jetës.

Jeta përmban çaste gëzimi dhe vështirësie. Kur njeriu përjeton mirësi, gëzohet; kur përballet me sprova, mund të mërzitet. Besimtari përpiqet të jetë mirënjohës kur i vijnë të mirat dhe i duruar kur përballet me vështirësi. Kështu, si mirësitë, ashtu edhe sprovat mund të bëhen shkak për forcimin e marrëdhënies së tij me Allahun.

Hadithi na mëson se besimtari i pjekur dallohet nga mënyra se si i përballon rrethanat e jetës. Ai përpiqet të ruajë besimin dhe të gjejë një qëndrim të drejtë, edhe kur gjërat nuk shkojnë sipas dëshirës së tij.

Përballë së njëjtës sprovë, njerëzit mund të reagojnë ndryshe. Disa tregojnë forcë dhe qëndrueshmëri edhe në vështirësi të mëdha, ndërsa të tjerë mund ta përjetojnë një problem të vogël si një fatkeqësi të pakapërcyeshme. Në raste të rënda, dëshpërimi mund t'i çojë disa njerëz drejt mendimeve apo veprimeve vetëshkatërruese. Prandaj, është e rëndësishme të mos i gjykojmë ata që vuajnë, por t'u ofrojmë mbështetje, dhembshuri dhe ndihmë të përshtatshme.

Duhet të ruhemi nga pakënaqësia e vazhdueshme dhe të mësojmë të jemi mirënjohës për të mirat që na ka dhënë Allahu. Durimi përballë fatkeqësisë mund të na ndihmojë të nxjerrim mësime, të bëhemi më të kujdesshëm dhe të mos i përsërisim gabimet. Kjo është pjesë e edukimit të vetes përmes durimit. Hadithi na kujton se besimtari i pjekur përpiqet t'i përballojë sprovat me besim dhe vullnet, ndërsa reagimi ynë ndaj vështirësive ndikon në mënyrën si e përjetojmë dhe e forcojmë imanin.

Fakti që besimtari ka iman nuk do të thotë se do të jetë i përjashtuar nga sprovat dhe fatkeqësitë. Ashtu si gjithë njerëzit, edhe ai do të përballet me vështirësi. Megjithatë, ai mund të gjejë forcë për t'i përballuar ato përmes durimit, lutjes, mbështetjes te Allahu dhe ndihmës së njerëzve përreth.

Për të kaluar nga një jetë e rënduar prej vështirësive drejt një jete më të mirë, duhet të përpiqemi të bëhemi besimtarë më të mirë dhe të punojmë vazhdimisht për përmirësimin e vetes. Një pjesë e rëndësishme e forcimit të imanit është durimi: të qëndrojmë të palëkundur, të mos humbasim shpresën dhe të vazhdojmë të bëjmë atë që është e drejtë, edhe kur rruga bëhet e vështirë.

| MARSIDA DANI |

DASHURIA E PROFETIT ﷺ për nënën dhe babanë



Një hadith

"Gjëja e parë që do të vendoset në peshoren e veprave në Ditën e Kiametit është morali i bukur."

(Et-Taberani, el-Mu'xhem el-Kebir, 24/253).

Profeti ynë i dashur (s.a.s.) e kishte humbur babanë para se të vinte në këtë botë dhe nënën kur ishte ende fëmijë i vogël. Ai ishte rritur jetim dhe pa nënë. Allahu i Madhëruar e kishte lënë pa prindër, por e kishte marrë nën kujdesin, mbrojtjen dhe edukimin e Tij të veçantë. Profeti (s.a.s.) thoshte: "*Zoti im më edukoi dhe ma përsosi edukimin.*"

Nuk ka njeri tjetër që të na e mësojë më mirë se ai të drejtën dhe vlerën e prindërve. Pas Allahut dhe të Dërguarit të Tij (s.a.s.), ndër njerëzit që kanë më shumë të drejta mbi ne janë prindërit. Ata janë gjithashtu njerëzit që meritojnë më shumë respekt dhe nderim.

Allahu i Madhëruar, duke na tërhequr vëmendjen për rëndësinë e të drejtave të prindërve, urdhëron:

"Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Tij dhe të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë pranë teje, mos u thuaj as 'of!' dhe mos i qorto, por drejtoju atyre me fjalë të respektueshme. Shtrije para tyre krahun e përuljes nga mëshira dhe thuaj: 'Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më rritën kur isha i vogël!"

(Kuran, Surja Isra, 17:23–24)

Abdullah ibn Mesudi (r.a.) transmeton: E pyeta të Dërguarin e Allahut (s.a.s.): "Cila vepër është më e dashura tek Allahu?"

Ai u përgjigj: "Falja e namazit në kohën e tij." "Po më pas, cila?" "Mirësjellja ndaj prindërve." "Po më pas?""Xhihadi në rrugën e Allahut."

Dashuria për nënën dhe babanë

Kur i shqyrtojmë hadithet e Profetit (s.a.s.), mësojmë se e drejta e nënës është tri herë më e madhe se ajo e babait.

Ebu Hurejra (r.a.) transmeton se një burrë erdhi te Profeti (s.a.s.) dhe e pyeti:

"O i Dërguari i Allahut, kush e meriton më shumë shoqërinë dhe mirësinë time?"

Ai iu përgjigj: "*Nëna jote.*"

Burri pyeti: "Po pastaj, kush?"

Ai tha: "*Nëna jote.*"

Burri pyeti përsëri: "Po pastaj?" Ai u përgjigj: "*Nëna jote.*"

Burri pyeti: "Po pastaj?" Ai tha: "*Babai yt.*"

Ky hadith nuk duhet interpretuar sikur babai të lihet pas dore, por na kujton se nëna ka një përparësi të veçantë për shkak të barrës së shtatzënisë, lindjes, gjidhënies dhe përkujdesjes ndaj fëmijës.

Një tjetër burrë erdhi te Profeti (s.a.s.) dhe i tha:

"O i Dërguari i Allahut! Në një ditë shumë të nxehtë, e mora nënën time mbi supe dhe eca me të për një rrugë të gjatë, nën rrezet përvëluese të diellit. A mendon se ia kam shlyer kështu të drejtën?"

Profeti (s.a.s.) iu përgjigj:

"*Me këtë shërbim që i ke bërë, ndoshta ke shlyer vetëm një pjesë të vogël të mundimit që ajo ka përjetuar gjatë lindjes tënde.*"

Fëmijët që flisnin që në djep



I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë se kanë qenë vetëm tre persona që kanë folur kur ishin ende në djep. I pari ishte Isai, i biri i Merjemes. I dyti ishte ky që do t'ju tregojmë më poshtë.

Xhurejxhi ishte një njeri i përkushtuar ndaj adhurimit. Ai ishte tërhequr në një faltore të vogël dhe merrej me adhurim. Një ditë, ndërsa po falej, nëna e tij erdhi pranë dhe e thirri:

"O Xhurejxh! Eja tek unë, dua të flas me ty. Jam nëna jote!"

Xhurejxhi mendoi me vete: *"O Allahu im! Kujt t'i përgjigjem më parë, nënës sime apo namazit tim?"*

Ai vendosi të vazhdonte namazin. Nëna e thirri tri herë, gjatë tri ditëve, por ai nuk iu përgjigj. Në fund, ajo u lut: *"O Allahu im! Mos e bëj të vdesë pa ia treguar fytyrat e grave të këqija!"*

Ndërkohë, izraelitët e përmendnin Xhurejxhin dhe adhurimin e tij. Në atë vend jetonte edhe një grua e njohur për bukurinë e saj, por që ishte e dhënë pas imoralitetit. Ajo tha: *"Nëse dëshironi, unë do ta vë në sprovë Xhurejxhin!"*

Ajo shkoi tek ai dhe u përpoq ta joshte, por Xhurejxhi nuk iu përgjigj. Atëherë gruaja shkoi te një bari, i cili gjendej pranë faltores së Xhurejxhit. Ajo kreu marrëdhënie të paligjshme me të dhe mbeti shtatzënë. Kur lindi fëmijën, tha: *"Ky fëmijë është i Xhurejxhit!"*

Kur e morën vesh këtë, njerëzit u zemëruan. Shkuan te fatorja, e nxorën Xhurejxhin prej saj, e shkatërruan ndërtesën dhe filluan ta fyenin e ta godisnin.

Xhurejxhi i pyeti: *"Çfarë ka ndodhur me ju?"*

Ata iu përgjigjën: *"Ti ke kryer marrëdhënie imorale me këtë grua dhe ajo ka lindur një fëmijë prej teje!"*

Xhurejxhi i pyeti: *"Ku është fëmija? Ma sillni!"*

Njerëzit ia sollën fëmijën. Ai u tha: *"Më lini të fal namazin tim!"*

Ata e lanë dhe ai u fal. Pasi përfundoi namazin, shkoi pranë fëmijës, e preku lehtë në bark dhe e pyeti:

"O fëmijë! Kush është babai yt?"

Fëmija u përgjigj: *"Filani, bariu!"*

Kur dëgjuan këtë, njerëzit u penduan për atë që kishin bërë. Ata iu afruan Xhurejxhit, i kërkuan falje dhe i thanë: *"Do ta rindërtojmë faltoren tënde prej ari!"*

Ai u përgjigj: *"Jo! Rindërtojeni siç ishte më parë, prej tullash balte!"*

Dhe kështu vepruan.

I Dërguari i Allahut (a.s) vazhdoi rrëfimin:

Fëmija i tretë që foli në djep ishte ky:

Një nënë po i jepte gji fëmijës së saj. Pranë tyre kaloi një burrë i pashëm, i veshur me rroba të bukura dhe i hipur mbi një kalë të hijshëm. Nëna u lut:

"O Allahu im! Bëje edhe djalin tim si ky burrë!"

Fëmija e lëshoi gjirin, u kthye nga burri dhe tha:

"O Allahu im! Mos më bëj si ai!"

Pastaj u kthye përsëri nga gjiri i nënës dhe vazhdoi të pinte.

I Dërguari i Allahut (a.s.) tha se më pas kaloi një grup njerëzish, të cilët po tërhiqnin zvarrë një grua skllave dhe e rrihnin, duke i thënë:

"Ke kryer imoralitet! Ke vjedhur!"

Gruaja u përgjigjej: *"Allahu më mjafton mua! Ai është mbrojtësi më i mirë!"*

Kur nëna e pa këtë, u lut:

"O Allahu im! Mos e bëj djalin tim si kjo grua!"

Atëherë fëmija e lëshoi përsëri gjirin, e pa gruan dhe tha:

"O Allahu im! Bëmë si ajo!"

Në këtë çast, nëna dhe fëmija nisën të bisedonin me njëri-tjetrin.

Nëna i tha: "O biri im! Kaloi një burrë i pashëm, me rroba të bukura, dhe unë u luta: *'O Allahu im! Bëje djalin tim si ai!'* Por ti the: *'O Allahu im! Mos më bëj si ai!"*

Fëmija u përgjigj: *"Po, nënë!"*

Ajo vazhdoi: "Pastaj kaluan njerëzit që po rrihnin atë gruan dhe i thoshin se kishte kryer imoralitet dhe kishte vjedhur. Unë u luta: *'O Allahu im! Mos e bëj djalin tim si ajo!'* Por ti the: *'O Allahu im! Bëmë si ajo!'* Pse, biri im?"

Fëmija u përgjigj:

"Sa i përket burrit të hipur mbi kalë, ai ishte një njeri tiran dhe zullumqar. Prandaj unë u luta: 'O Allahu im! Mos më bëj si ai!'

Ndërsa gruaja, të cilën po e rrihnin dhe e akuzonin për imoralitet e vjedhje, nuk kishte kryer as imoralitet dhe as vjedhje. Prandaj u luta: *'O Allahu im! Bëmë si ajo!'"*

(Buhariu, Enbija, 50; Amel fi's-Salat, 7; Muslimi, Birr, 7-8.)

I DRAGUSH SELAHUDIN ÇABEJ I

Kur na hyri Kur'ani në shtëpi



Kur na hyri Kur'ani në shtëpi[1],
Perëndoi nata e një shekulli të zi;
Zemrat tona me një hov të ri,
Njeriu filloi ta ndjejë veten njeri,
Sepse kishte pasur frikë nga hija e tij.

Kur na hyri Kur'ani në shtëpi,
Na u ringjall shpirti, na erdhi fuqia,
Na erdhi fryma edhe mbarësia,
Na erdhi urata edhe mirësia,
Na hyri ndjesa edhe bujaria.

Kur na hyri Kur'ani në shtëpi,
Na u gjallërua dëshira për punën,
Për punën, gëzimin e njeriut,
Për punën, shpëtimin e njeriut,
Për punën, bekimin e njeriut.


Kur na hyri Kur'ani në shtëpi,
Nuk e ndjemë më veten jetimë e në vetmi;
Nuk qenkëshim më një milion e dy e tri.
Në Ballkan për ne s'ka më trysni,
Dhunë, kërcënim, pasiguri edhe uri,
Sepse që nga Maroku deri në Indonezi;
Në Egjipt, Arabi, Kuvajt, Turqi...
Kemi mbi një miliard vëllezër me besë e me gjak,
Që i frymëzon All-llahu dhe
mbajnë KUR'ANIN.

Kur na hyri Kur'ani në shtëpi,
Na pruri betimin e prindërve të parë;
Të respektojmë dhe kishën si xhami;
Katolikë, ortodoksë e muslimanë
Janë vëllezër, të bashkuar e të pandarë,
Mbi të gjitha: jemi SHQIPTARË!

1. Botuar në gazetën Drita Islame, e përdyjavshme e Komunitetit Musliman-Tiranë, nr. 27, shkurt 1993.



BOTIMET KMSH



KY BOTIM PËRMBLEDH KUMTESAT SHKENCORE TË KONFERENCËS SË ZHVILLUAR NË TIRANË, MË 13 DHJETOR 2025, ME KONTRIBUTIN E TRI BASHKËSIVE ISLAME: SHQIPËRISË, KOSOVËS DHE MAQEDONISË SË VERIUT.

VEPRA SJELL NË VËMENDJE TRASHËGIMINË E IMAM ABDULLAH B. MAHMUD EL-MEVSILIUT DHE RËNDËSINË E VEPRËS SË TIJ NË TRADITËN JURIDIKE HANEFITE.

NJË BOTIM ME VLERË PËR DIJEN DHE TRASHËGIMINË JURIDIKE ISLAME.

WWW.KMSH.AL

BOTIM I RI